



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. 7/2018 regjistër (JR)
Datë 09.07.2018**

**Nr. 07 i vendimit
Datë 25.09.2018**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit i përbërë nga gjyqtarët:

Kryesuese	Albana Shtylla
Relatore	Ina Rama
Anëtar	Luan Daci
Anëtare	Natasha Mulaj
Anëtare	Rezarta Schuetz

mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 25.09.2018, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar John Leonardo, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

ANKUES:

Fatmir Ismail Hoxha, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuar me prokurën e posaçme nr. 357 rep. dhe nr. 199 kol., datë 4.05.2018, nga Avokat Julian Mërtiri (me nr. licence 3341), Anëtar i Dhomë së Avokatëve Tiranë, me adresë: rruga “Ismail Qemali”, pallati. 11/1, ap. 1, Tiranë.

OBJEKTI:

Ndryshimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 18, datë 10.05.2018, dhënë për subjektin e rivlerësimit, z. Fatmir Ismail Hoxha, dhe konfirmimin e tij në detyrë.

BAZA LIGJORE:

Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 63 dhe 66, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, shqyrtoi gjithë dokumentacionin e administruar në dosje dhe pasi bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 18, datë 10.5.2018, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, pasi ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në këto konkluzione:
 - a. Ka deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për burimin e krijimit të pasurisë apartament 2 + 1, me sipërfaqe totale 112,36 m², të ndodhur në rr. {***}, godina {***}, shk. {***}, ap. {***}, kati {***}, Tiranë, pasi në deklaratën “vetting” 2017 nuk është deklaruar si burim huaja e marrë shtetasit A. G, në vlerën prej 28.500 eurosh.
 - b. Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua shtetasit A. G., në vlerën prej 28.500 eurosh.
 - c. Ka mospërputhje midis shumës së të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2011 në masën që shpenzimet tejkalojnë të ardhurat me 1.752.123 lekë, shumë e cila nuk është shpjeguar në mënyrë të arsyeshme.
 - ç. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur duke mos e deklaruar shumën prej 330.000 lekësh, gjendje në llogarinë depozitë të bashkëshortes pranë BKT, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.

II. Shkaqet e ankimit

2. Fatmir Hoxha ka ushtruar detyrën e gjyqtarit që nga viti 1991. Që prej vitit 2013, është gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, detyrë për shkak të së cilës u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi në kohë, bazuar në nenin 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
3. Subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha, me ankimin e paraqitur, kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim Kolegji) ndryshimin e vendimit nr. 18, datë 10.05.2018, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme.
4. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit kundërshton standardin e arsytimit të vendimit nga ana e Komisionit, cenimin e standardit për një proces të rregullt, shkeljen e parimit të barazisë së armëve.

5. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pretendime për ligjin e zbatueshëm dhe përparësinë e zbatimit të ligjit organik, si dhe për zbatim të gabuar të ligjit material në arritjen e përfundimeve, mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja.
6. Arsyetimi i vendimit nuk rezulton të ketë një analizë të provave dhe fakteve të administruara në proces, në funksion të një interpretimi që u duhej bërë normave kushtetuese dhe ligjore mbi të cilat bazohet vendimmarrja. Komisioni nuk ka kuptuar qëllimin dhe rregullimin e jashtëzakonshëm të ligjit nr. 84/2016.
7. Sipas ankimit, konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “vetting” 2017, për mosdeklarimin si burim krijimi të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 112,36 m², të huas së marrë nga shtetasi {***}, në vlerën prej 28.500 eurosh, është i gabuar dhe jo i mbështetur në ligj. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ai nuk ka pasur detyrimin ta deklaronte këtë hua, duke qenë se ajo ishte shlyer në vitin 2014 dhe ky fakt ishte deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2015. Komisioni, sipas ankuesit, nuk bën dallim midis “pasurisë” dhe “burimit të krijimit të saj” në kuptim të detyrimeve për deklarim të subjektit të rivlerësimit dhe se Komisioni ka gabuar kur barazon “pasurinë” dhe pasaktësinë e deklarimit të saj me “burimin e krijimit” për të cilin ligji vendos detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të dhënë një shpjegim bindës.
8. Komisioni nuk ka kuptuar se procesi i rivlerësimit ka përcaktuar rregulla të posaçme mbi të cilat do të kryhet vlerësimi i pasurisë dhe nga ky vlerësim do të rezultojë nëse janë kryer deklarime të pasakta dhe të paplota.
9. Komisioni, në hetimet paraprake të datës 20.03.2018, nuk ka evidentuar si problematikë mosprovimin me dokumentacion të burimit të ligjshëm të krijimit të shumës prej 28.500 eurosh, të marrë hua nga z. {***}. Ky fakt nuk është pretenduar nga Komisioni as në seancë dëgjimore, madje nuk pati asnjë pyetje nga Komisioni. Në këto rrethana, evidentimi i kësaj gjetjeje të mosprovueshmërisë me dokumentacion të burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj shume të marrë hua, si një nga shkaqet për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, për arsytet e mësipërme, e bën këtë proces të parregullt dhe të njëanshëm. Prandaj ankuesi e konsideron gjithashtu të paligjshëm si procesin e zhvilluar nga ana e Komisionit, ashtu edhe përfundimin në të cilin u arrit në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, huadhënësit, z. {***}.
10. Komisioni nuk ka arsyetuar pse nuk janë gjetur bindëse shpjegimet e z. {***} dhe Komisioni nuk ka ushtruar kompetencën e tij në kërkimin dhe marrjen e provave të pretenduara nga z. {***} dhe nuk ka bërë verifikim të plotë të deklarimeve dhe të personit tjetër të lidhur dhe për këtë arsye ka paraqitur së bashku me ankimim disa akte.
11. Arsyetimi i Komisionit që të ardhurat e siguruar nga shitja e orendive të shtëpisë së tij në qytetin e Shkodrës cilësohen jo të ligjshme, është i gabuar. Komisioni nuk arriti të argumentojë se përse nuk i konsideroi të ligjshme të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si rrjedhojë e shitjes së sendeve të luajtshme (mobileve në pronësinë e tij).

12. Vlerësimi i Komisionit për diferencë në shpenzime krahasuar me të ardhurat e deklaruara, në shumën 1.752.123 lekë për vitin 2011, nuk është ligjërishit i bazuar dhe nuk mund të jetë bazë ligjore për shkarkimin nga detyra. Konstatimi i Komisionit se diferenca e krijuar në vitin 2011, në shumën 1.752.123 lekë, është si rrjedhojë e shpenzimeve për mobilimin e apartamentit të ri në Tiranë në vlerën 2.500.000 lekë, me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, për të njëjtin vit, është i gabuar.
13. Vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka fshehur duke mos deklaruar shumën prej 330.000 lekësh, gjendje në llogarinë depozitë të bashkëshortes pranë BKT-së, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, është jo i drejtë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se rezultoi i provuar tejet çdo dyshimi fakti se kemi të bëjmë me një lapsus e harresë materiale në deklarimin e vitit përkatës. Sipas ankuesit në kushtet e një ligji dhe detyrimi të ri, kryerja e një lapsusi të tillë ka qenë një veprim i cili është korrigjuar pa asnjë pasojë, menjëherë në vitin pasardhës 2004 e në vijim.
14. Komisioni në vendimmarrjen e tij ka zbatuar e interpretuar gabim nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, “Shkarkimi nga detyra”. Kjo dispozitë është bazuar në nenin “D” të Aneksit të Kushtetutës. Në rrethanat kur është deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasuria që disponohet, dukshëm dhe tejet çdo interpretimi nuk përmbushet kushti ligjor i “deklarimit të më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme”, rrethanë e cila do të përbënte një shkak të ligjshëm për dhënien e masës disiplinore të “shkarkimit nga detyra”, siç është vepruar nga Komisioni në vendimin objekt ankimi.
15. Arsyetimi i Komisionit sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha ka arritur një nivel minimal kualifikues profesional, sepse nuk ka interpretuar dhe zbatuar drejt parashikimet e ligjit të posaçëm për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

16. Kompetencat e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit përcaktohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, si dhe në nenin 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016. Këto dispozita respektivisht parashikojnë:

“5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese. [...]”;

“1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë.

2. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar [...]”.

Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, sipas nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48/1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012). Këto dispozita, ndër të tjera, parashikojnë zhvillimin si rregull të

seancave në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh (neni 49, ligji 49/2012) ose në seancë gjyqësore në rastet kur debati gjyqësor çmohet i nevojshëm nga gjykata (neni 51 i ligjit 49/2012)¹. Kolegji vendosi ta shqyrtojë këtë çështje në dhomë këshillimi.

17. Kolegji vlerëson se ankuesi legjitimohet në aspektin personal, bazuar në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton: “Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit”, pasi ankimi është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe nga avokati i pajisur rregullisht me prokurë të posaçme.
18. Ankuesi legjitimohet edhe në aspektin kohor, bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.”
19. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur së bashku me ankimin akte shkresore, të cilat kërkohen të merren si provë nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim trupi gjykues). Këto akte shkresore janë marrë nga personi tjetër i lidhur pasi është dhënë vendimi i Komisionit dhe, sipas subjektit të rivlerësimit, ato kanë qenë të pamundura për t’u marrë më parë, por janë të rëndësishme për të provuar aktivitetin tregtar të këtij personi, pra të z. {***}.
20. Aktet shkresore, për të cilat iu kërkua trupit gjykues që t’i marrë në cilësinë e provës, janë:
 - i) Shkresë nr. {***} prot., datë 13.06.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me lëndë “Kthim përgjigje” drejtuar {***}.
 - ii) Pasaportë e shtetasit {***}, me nr. {***}, lëshuar nga Ministria e Brendshme, datë 24.01.1996, me vlefshmëri 6-vjeçare (deri më 24.03.2002).
 - iii) Kontratë depozite bankare e z. {***} pranë ProCredit Bank, e datës 31.12.2010, për vlerën 2.500 euro.
 - iv) Vërtetim i ProCredit Bank për depozitën me afat, i datës 23.06.2010, për z. {***}, i cili në këtë datë rezulton të ketë pasur pranë kësaj banke 5 (pesë) llogari bankare/depozita të çelura në datat dhe me fondet përkatëse, së bashku me kontratat, mandat pagesat dhe aktet provuese të këtyre llogarive.
 - v) Shkresë nr. {***} prot., datë 13.06.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me të cilën përcillen të dhënat e regjistruara në sistemin informatik doganor dhe *database*-t e statistikës për z. {***}, për periudhën 2004-2010.
 - vi) Shkresë nr. {***} prot., datë 13.06.2018, “Kthim përgjigje”, e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër, drejtuar z. {***}.
 - vii) Shkresë nr. {***} prot., datë 08.06.2018, “Kthim përgjigje”, e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër, drejtuar z. {***}.

¹ Neni 51, paragrafi 1 i ligjit 49/2012 përcakton: “[...] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm [...]”.

- viii) Akt shitblerje pasuri e luajtshme (automjet) nr. {***} rep. dhe nr. {***}kol., datë 02.03.2004, hartuar pranë noteres {***}.
- ix) Akt shitblerje pasuri e luajtshme (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. {***}kol., datë 07.07.2004, hartuar pranë noteres {***}.
- x) Kontratë shitblerje (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. {***}kol., datë 01.12.2004, të hartuar pranë noteres {***}.
- xi) Kontratë shitblerje (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. {***}kol., datë 15.01.2006, të hartuar pranë noteres {***}.
- xii) Kontratë shitblerje (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. 23{***}85 kol., datë 09.11.2006, të hartuar pranë noteres {***}.
- xiii) Kontratë shitblerje (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. {***}kol., datë 06.02.2007, të hartuar pranë noteres {***}.
- xiv) Kontratë shitblerje (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. {***}kol., datë 03.05.2007, të hartuar pranë noteres {***}.
- xv) Kontratë shitblerje (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. {***}kol., datë 20.06.2007, të hartuar pranë noteres {***}.
- xvi) Kontratë shitblerje (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. {***}kol., datë 26.05.2009, të hartuar pranë noteres {***}.
- xvii) Kontratë shitblerje (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. {***}kol., datë 07.07.2009, të hartuar pranë noteres {***}.
- xviii) Kontratë shitblerje (automjet) nr. {***}rep. dhe nr. {***}kol., datë 10.07.2009, të hartuar pranë noteres {***}.
- xix) 8 (tetë) kërkesa të z. {***} drejtuar institucioneve dhe subjekteve të treta, të gjitha më datë 01.06.2018:
 - Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;
 - Degës së Doganës Durrës;
 - Degës së Doganës Shkodër;
 - Ambasadës Italiane Tiranë;
 - Ambasadës Italiane Shkodër;
 - Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
 - Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
 - Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër.

21. Trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos i administrojë aktet e paraqitura së bashku me ankimin, në cilësinë e provës në gjykim, pasi ato nuk plotësonin kushtet e përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili përcakton:

“Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.”

Siç edhe rezulton në shkresat e sipërcituara, ato janë kërkuar në organet shtetërore apo te personat fizikë dhe juridikë vendas nga z. {***}, personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi është marrë vendimi nga Komisioni, duke provuar në këtë mënyrë plotësisht mundësinë e tij për t’i paraqitur ato gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, pavarësisht pretendimeve të parashtruara prej tij për të kundërtën. Kolegji vëren se në mungesë të një arsytimi bindës nga ana e subjektit të rivlerësimit për sa i përket mosparaqitjes së të njëjtave prova lidhur me personin tjetër të lidhur, z. {***}, gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, pavarësisht detyrimit kushtetues dhe ligjor për të provuar me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e pasurisë dhe të të ardhurave të tij, zbatohen parashikimet e nenit 47 të ligjit 49/2012 që ndalon paraqitjen e provave të reja në gjykim.

22. Në lidhje me provueshmërinë e gjendjes faktike, neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 përcakton:

“4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.”

23. Kolegji vlerëson se provat e administruara nga Komisioni janë në përputhje me neni 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe kanë qenë përcaktuese për gjendjen e fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Po ashtu, dokumentet përkatëse vijnë nga burime të njohura, prova të besueshme dhe në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Për arsye se gjendja faktike është konstatuar saktë dhe në mënyrë të plotë, nga prova në pajtueshmëri me njëra-tjetrën dhe të marra nga burime të besueshme, Kolegji e vlerëson të panevojshëm debatin gjyqësor në seancë publike gjyqësore dhe marrjen e provave të reja.

24. Provat e reja të paraqitura me ankimin nga subjekti i rivlerësimit u refuzuan, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 edhe sepse, nga vlerësimi i përmbajtjes së tyre, rezultoi se edhe nëse do të konsideroheshin të vërteta, fakti që kërkohet të provohej ishte i parëndësishëm për vendimmarrjen e trupit gjykues, siç shtjellohet më poshtë.

25. Në pikën 1 të aktit datë 20.03.2018 të Komisionit, “Rezultatet e hetimit paraprak”, subjekti i rivlerësimit është njoftuar se në deklaratën “vetting” 2017 nuk ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament 2 + 1, me sipërfaqe totale 112,36 m², ndodhur në rr. {***}, godina {***}, shk. {***}, ap. {***}, kati {***}, Tiranë, borxhin e marrë nga kunati, z. {***}. Në përgjigjen e cituar, subjekti i rivlerësimit ka pranuar që huaja nga z. {***} ka qenë një nga burimet e përdorura, duke mbartur në këtë mënyrë detyrimin që, në zbatim të Nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, duhet të provonte ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur. Në fund të aktit datë 20.03.2018, Komisioni e ka njoftuar se i ka kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

26. Pas përcjelljes së rezultateve të hetimit paraprak, me procesverbalin datë 29.03.2018, Komisioni i ka dorëzuar personalisht subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha të gjitha aktet e dosjes së hetimit administrativ të kryer nga Komisionit. Si rrjedhojë, ai është njohur ndër të tjera edhe me: a) shkresat e Komisionit nr. {***}, datë 24.01.2018, dhe nr. {***}, datë 01.02.2018, drejtuar kumatit të tij z. {***}, nëpërmjet të cilave i kërkohej që të konfirmonte nëpërmjet një deklaratë huan, si dhe të provonte me dokumente shkresore ligjshmërinë e të ardhurave të dhëna hua; b) shkresat e Komisionit për Drejtorin e Përgjithshme të Tatim Taksave për personin tjetër të lidhur, nr. {***}prot., datë 4.12.2017, nr. {***}prot., datë 13.12.2017, si dhe shkresat drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit nr. 2{***}121 prot., datë 21.12.2017 dhe nr. {***}prot., datë 5.03.2018; c) dëshminë që z. {***} ka dhënë në Komision në datën 21.02.2018, në zbatim të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, germa “b” para personelit të Komisionit, pyetjet që ata i kanë drejtuar etj.
27. Në seancën publike, relatori i çështjes ka theksuar ndër të tjera: “Ky hetim është përqendruar te burimi i ligjshëm i të ardhurave për pasurinë e mëposhtme: apartament 2 + 1, me sipërfaqe totale 112,36 m², i ndodhur në adresën rr. {***}, godina {***}, shk. {***} ap. {***}, Tiranë”². Në vazhdim, relatori ka theksuar se “subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e hetimit paraprak, kryesisht të kryer nga Komisioni, lidhur me pasurinë apartament banimi 2 + 1 me sipërfaqe 112,36 m², duke analizuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Hetimi i Komisionit, me qëllim analizimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, u përqendrua kryesisht në: hetimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave për personin tjetër të lidhur, {***}; burimin e krijimit të likuiditeve në vite [...]”
28. Subjekti i rivlerësimit ka qenë i informuar se Komisioni si gjatë hetimit administrativ, ashtu dhe në seancë dëgjimore, për vlerësimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave për krijimin e pasurisë apartament banimi, sipërfaqe totale 112,36 m², në adresën rr. {***}, Tiranë, ka hetuar për ligjshmërinë e të ardhurave edhe të personit tjetër të lidhur, z. {***}, përfshirë këtu edhe provueshmërinë me dokumentacion të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Ndërsa neni 32, pikat 1 dhe pika 4 të ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë përkatësisht:
- “1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...].
- “4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”

² Procesverbali i seancës publike, faqe 3 (nr. indeksi 1148).

29. Në zbatim të sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar³ z. {***}, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, që të konfirmonte nëpërmjet një deklaratë huan, **si dhe të provonte me dokumente shkresore ligjshmërinë e të ardhurave të dhëna hua.** Pasi Komisioni në datën 21.02.2018 realizoi edhe marrjen e dëshmisë së z. {***}, vlerësoi se kishte arritur nivelin e provueshmërisë për ligjshmërinë e të ardhurave të këtij të fundit, siç ishin pranuar edhe nga subjekti i rivlerësimit se kishin shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe totale 112,36 m², në rr. {***}, Tiranë.
30. Kolegji vëren se Komisioni në përcjelljen e “Rezultateve të hetimit paraprak” duket se ia ka vënë në dukje shprehimisht subjektit të rivlerësimit gjendjen procedurale në të cilën ai ndodhej, duke i paraqitur shtatë (7) gjetje të Komisionit dhe, si rezultat, i është referuar nenit D, paragrafit 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 duke informuar subjektin e rivlerësimit që i ka kaluar barra e provës për këto shtatë gjetje.
31. Sipas institutit të barrës së provës, bazuar në parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ndër të tjera, të provojë me dokumentacion ligjshmërinë e burimeve të tij, dhe ky detyrim duhet të zbatohet prej tij *ipso legge* dhe jo vetëm kur i kërkohet shprehimisht të paraqitet një dokument nga Komisioni. Komisioni në përfundim të hetimit administrativ, pasi krijon bindjen se provat kanë arritur për të nivelin e provueshmërisë, vendos që t’i japë të drejtën subjektit të rivlerësimit të njihet me dosjen duke i kaluar dhe barrën e provës për të provuar të kundërtën për gjetjet që kanë rezultuar nga hetimi paraprak, pa qenë e nevojshme t’i kërkojë duke listuar në mënyrë të detajuar çdo kërkesë që i duhet drejtuar subjektit të rivlerësimit, për t’u sqaruar apo provuar gjetjet e trajtuara në rezultatet e hetimit. Është detyrë e subjektit të rivlerësimit të vlerësojë mënyrën se si ai do të realizojë mbrojtjen e tij, si dhe dokumentacionin që ai duhet të paraqesë për të provuar të kundërtën për gjetjen që Komisioni ka parashtruar në rezultatet e hetimit paraprak. Rëndësi gjatë këtij procesi ka e drejta e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me çdo akt të dosjes, duke i garantuar në këtë mënyrë qartësinë që për çdo konstatim, gjetje, apo vlerësim të kryer nga Komisioni, subjektit të rivlerësimit t’i jetë respektuar mundësia për t’u mbrojtur me prova dhe të dëgjohet për argumentet e tij. Të drejtën për t’u njohur, mbrojtur dhe dëgjuar, subjekti i rivlerësimit e ka edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore publike në Komision.
32. Gjykata Kushtetuese, lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, është shprehur në vendimin nr. 16/2013:

“[...] Gjykata Kushtetuese ka tashmë një praktikë të konsoliduar sipas së cilës parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që në çështjet civile secilës palë në gjykim t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve të cilat nuk e vendosin në dizavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës.”

³ Shih shkresat nr. {***} datë 24.01.2018 dhe nr. {***} datë 01.02.2018, drejtuar {***}.

33. Siç rezulton nga aktet e dosjes, Komisioni ka realizuar njoftimin te subjekti i rivlerësimit, për çështjet që ka hetuar gjatë fazës së hetimit paraprak, mbi të cilat ka rritur nivelin e provueshmërisë, si dhe i ka i vënë në dispozicion të gjitha aktet që ka administruar për secilën prej tyre deri në atë moment, duke i krijuar në këtë mënyrë dhe mundësinë e arsyeshme për t'i vlerësuar ato dhe, më tej, për të paraqitur pretendimet e tij. Subjekti i rivlerësimit bazuar në kërkimet dhe hetimin që kishte bërë Komisioni, si dhe në kërkimet apo pyetjet që i ishin drejtuar personit tjetër të lidhur, z. {***}, ka qenë në kushtet e qartësisë për të çmuar që në përgjigjen e tij për rezultatet e hetimit paraprak, por edhe në seancën publike, të paraqiste dokumentacionin justifikues për ligjshmërinë e të ardhurave të këtij personi.
34. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të standardit për një proces të rregullt, shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në proces, pasi nuk i është njoftuar në mënyrë të shprehur me rezultatet e hetimit paraprak mosprovueshmëria me dokumentacion e burimit të krijimit të huas 28.500 euro nga huadhënësi {***}, është i pabazuar.
35. Neni 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, përcakton:
- “Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit.” Dhe neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 përcakton: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë [...]”.
36. Bazuar në rregullin e përgjithshëm, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, pasi Komisioni ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të saktë gjendjen faktike, vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi nuk rezulton të jetë bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë.
37. Subjekti i rivlerësimit, për pjesën që i përket kontrollit të pasurisë ka pretenduar mosarsyetimin e vendimit, pasi “në arsyetimin që ka zgjedhur të përdorë Komisioni për të argumentuar në vendim se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë një analizë të provave dhe fakteve të administruara në proces, në funksion të një interpretimi që i duhet bërë normës kushtetuese dhe ligjore, mbi të cilat bazohet vendimmarrja”.
38. Në kundërshtim me sa pretendon ankuesi, trupi gjykues vëren se në pjesën e arsyetimit ligjor dhe analizës së provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, Komisioni në pikën 3.5 arrin në cilësimin ligjor të faktit “të fshehjes së pasurisë” në shumën prej 330.000 lekësh, duke

konstatuar faktin që rezulton nga deklarata vjetore e pasurisë për vitin 2003 dhe gjendjen e depozitës së bashkëshortes së tij në llogarinë pranë bankës përkatëse, duke referuar për këtë qëllim edhe mbështetjen ligjore. Shprehimisht, Komisioni arsyeton: “3.5 Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të shumës së 330.000 lekëve në deklaraten e tij vjetore të pasurisë për vitin 2003, gjendje e depozitës së bashkëshortes së tij në llogarinë nr. {***} pranë BKT-së, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 61 dhe pikën 5/c të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016”.

39. Trupi gjykues vëren se në pjesën e arsytimit ligjor dhe analizës së provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, e më konkretisht në pikën 3.6⁴, Komisioni ka arritur në cilësimin ligjor të drejtë, të deklarimit të pamjaftueshëm dhe të mosdhënies të shpjegimeve bindëse në lidhje me të ardhurat e tij, duke referuar për këtë qëllim edhe mbështetjen ligjore në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Shprehimisht, Komisioni arsyeton: “[...] 3.6 Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me të ardhurat e pamjaftueshme, për të justifikuar shpenzimet e vitit 2003 për kriterin e kontrollit të pasurisë, referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dhe parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës [...]”, duke nënkuptuar të ardhura të pamjaftueshme për të justifikuar çeljen e depozitës bankare në shumën 330.000 lekë, në vitin 2003.

40. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 28/2014 është shprehur:

“Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërtënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese)”.

41. Neni 57 i ligjit nr. 84/2016 përcakton pjesët përbërëse të vendimit të Komisionit dhe elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit është në përputhje me standardin strukturor që parashikon neni 57 i ligjit nr. 84/2016 dhe neni 310 i Kodit të Procedurës Civile, si dhe vendimet interpretuese të Gjykatës Kushtetuese, e cila me jurisprudencën e saj orienton se vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Trupi gjykues konstaton se pjesët përbërëse të vendimit janë në unitet dhe të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe argumentet e dhëna nga Komisioni janë të mjaftueshme për të mbështetur përfundimet e arritura, ndërsa subjekti i rivlerësimit nuk parashtron se cilat pjesë të arsytimit janë të paargumentuara me ligj dhe në fakte. Për këto arsye, trupi gjykues çmon se ky shkak ankimi është i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

⁴ Shih faqen 11 të vendimit.

42. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pretendime për ligjin e zbatueshëm dhe përparësinë e zbatimit të ligjit organik, si dhe për zbatim të gabuar të ligjit material në arritjen e përfundimeve, mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja. Arsyetimi i vendimit nuk rezulton të ketë një analizë të provave dhe fakteve të administruara në proces, në funksion të një interpretimi që i duhej bërë normës kushtetuese dhe ligjore mbi të cilat bazohet vendimmarrja. Komisioni nuk ka kuptuar qëllimin dhe rregullimin e jashtëzakonshëm të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, ngre pretendime në lidhje me vlerësimin e nivelit të pabesueshmërisë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, si pasojë e fshehjes së pasurisë dhe deklarimit të pasaktë të saj.
43. Ankuesi kundërshton përfundimin e Komisionit se: “Ka deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën “vetting” nuk është deklaruar si burim huaja e marrë shtetasit {***} në vlerën prej 28.500 euro”. Sipas ankuesit, nga provat e administruara në Komision, por edhe nga verifikimet e realizuara nga vetë Komisioni, është provuar fakti se kjo hua e pretenduar si e marrë në muajin shkurt 2011, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin pasardhës 2012 dhe më pas disa vite rresht, deri në vitin 2015, kur në deklaratën e këtij viti deklarohet shlyerja e plotë e huas te huadhënësi, dhe për këtë arsye ankuesi pretendon se në momentin e plotësimit të formularit të deklarimit *vetting*, kjo hua ishte shlyer plotësisht me të ardhurat e vetë ankuesit dhe bashkëshortes së tij, duke sjellë për pasojë përfundimin e marrëdhënies së detyrimit, pra mosekzistencën e huas. Gjithashtu ankuesi kundërshton përfundimin e Komisionit se: “Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua shtetasit {***}, në vlerën prej 28.500 eurosh, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016”.
44. Megjithëse subjekti i rivlerësimit pretendon se ka marrë prej kunatit të tij, z. {***}, huan prej 28.500 eurosh, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur para Komisionit asnjë dokument justifikues të këtij veprimi juridik. Megjithatë, në bazë të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, huadhënësi i vetëdeklaruar, z. {***}, së bashku me subjektin e rivlerësimit kishin detyrimin ligjor dhe kushtetues që gjatë procesit të rivlerësimit të justifikonin dhe të argumentonin me dokumente shoqëruese ligjshëmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, pjesë kjo e çmimit të blerjes së apartamentit në Tiranë, me sipërfaqe 112,26 m², në rrugën {***}. Këtë detyrim nuk e përmbushën me gjithë afatin kohor dhe njoftimin për këtë gjetje që Komisioni dhe ligji nr. 84/2016 i kanë adresuar këtij subjekti. Pra, efektivisht i kishte kaluar edhe barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit të paligjshmërisë së burimit të huas. Subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues për të vërtetuar marrjen e kësaj huaje, dhe asnjë dokumentacion justifikues për pagimin e këtij borxhi nga viti 2011 deri në vitin 2015, pavarësisht detyrimit ligjor për ta bërë këtë dhe aq më pak ai nuk ka argumentuar pagimin e detyrimeve tatimore për këtë shumë, në kuptim dhe zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, që ta bënte atë subjekt të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
45. Bazuar në sa më sipër cituar, neni D, pikat 2 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, udhëzimi i ILDKPKI-së datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit jo vetëm për

deklarimin e “pasurisë” së tij, por edhe të “burimit” në momentin e krijimit të saj. Subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha që në pjesën “Deklarimi i pasurisë”⁵ kishte detyrimin të deklaronte në deklaratën e pasurisë “vetting” jo vetëm pasurinë apartament me sipërfaqe totale 112,36 m², në rr. {***} Tiranë, por dhe burimet të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie që në momentin e krijimit të saj, në vitin 2011. Duke qenë se në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha ka deklaruar se huaja prej 28.500 eurosh është marrë me qëllim blerjen e këtij apartamenti, atëherë në kuptim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi, kjo hua ka shërbyer si burim i krijimit të kësaj pasurie. Argumentimi nga subjekti i rivlerësimit se ai nuk e ka përfshirë këtë hua si burim të krijimit të pasurisë së tij, për arsye se në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë “vetting” ajo ishte e shlyer me të ardhurat e tij, dhe tashmë paga apo të ardhurat e tij janë burimi i krijimit të kësaj pasurie, është i gabuar dhe për më tepër nuk përkon në kohë. Subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha në pjesën “Deklarimi i pasurisë” të deklaratës së pasurisë “vetting” 2017, ka deklaruar si burim krijimi të këtij apartamenti: “kredi bankare në BKT në shumën 5 milionë lekë, me interes 4%, me afat shlyerjeje 22 vjet (deri në vitin 2034)”. Nëse mënyra e të kuptuarit të subjektit të rivlerësimit do të ishte deklarimi vetëm i huave të pashlyera në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë “vetting”, atëherë ai edhe për huan bankare⁶ do të duhej të deklaronte si burim krijimi të kësaj pasurie vetëm vlerën e saj, që ishte ende e pashlyer prej tij më 31 janar 2017 dhe jo totalin e saj në vlerën prej 5 milionë lekësh. Pra, kjo pasuri do të duhej të deklarohet prej tij se kishte si burim krijimi, ndër të tjera, pjesën e mbetur të pashlyer të kredisë deri më 31 janar 2017, si dhe pagat dhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha me të cilat ai kishte shlyer pjesën takuese të vlerës së huas, për periudhën nga viti 2011 deri më 31 janar 2017⁷.

46. Bazuar në sa më sipër, në lidhje me këtë shkak ankimor, trupi gjykues vlerëson të drejtë përfundimin e arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

47. Në nenin D të Aneksit të Kushtetutës parashikohet:

“2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin [...].

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

48. Ligji nr. 84/2016, në nenin 32 “Deklarimi i pasurisë”, përcakton:

“1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

[...]

⁵ Pra jo në pjesën “Detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”.

⁶ Kredinë e marrë nga BKT në vitin 2011.

⁷ Periudha nga marrja e kredisë deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë “vetting” 2017.

4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.”

49. Udhëzimi i ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikat 7, 15, 18 dhe 22 përcakton:

“7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre.

[...]

15. Deklarimi i huamarrjeve dhe huadhënies në likuiditete, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor dhe me vërtetimet bankare, në rast se veprimi në kohën e kryerjes së tij është kryer me transaksion bankar.

[...]

18. Nëse subjekti i rivlerësimit deklaron marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit, detyrohet të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit, të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë subjektit të rivlerësimit.

[...]

22. Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat i subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, të shoqërohet për periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe dividendin e tërhequr.”

50. Formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit⁸:

a. Në pjesën “Informacion në ndihmën tuaj”, përcakton:

“Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, e ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, e përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të subjekteve të

⁸⁸ Miratuar si shtojcë 2 e ligjit nr. 84/2016.

rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjin “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ILDPKI, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Mbi deklarinin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe ligjin nr. 44/2015 *Kodi i Procedurave Administrative*.”

b. Në pjesën “Deklarimi i pasurisë nga persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit”, përcakton:

“Persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Personat e tjerë të lidhur nëse konfirmojnë këto marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, mbartin detyrimin për deklarinin e pasurisë në Inspektoratin e Lartë, me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit të Pasurive të Paluajtshme.”

Gjithashtu në këtë formular, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, sqarohet:

“Objekti i deklarinimit: Të gjitha pasuritë e akumuluarra ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **burimet e krijimit të tyre** dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe **burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.**”

51. Subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha ka pretenduar se Komisioni nuk ka arsyetuar pse nuk janë gjetur bindëse shpjegimet e z. {***}, si dhe nuk ka ushtruar kompetencën e tij në kërkimin dhe marrjen e provave të pretenduara nga z. {***}, pra nuk ka bërë verifikim të plotë të deklaratimeve dhe të personit tjetër të lidhur. Sipas subjektit të rivlerësimit, z. {***} ka burim të ligjshëm të krijimit të shumës prej 28500 euro, pasi siç ka deklaruar edhe vetë ai në dëshminë para Komisionit, ai ka kryer aktivitet tregtar nga viti 1994-2011, duke shitur automjete dhe rroba e mobilie të përdorura dhe këtë e vërteton me hyrje-daljet e shumta në kufi, si edhe me vizat tregtare të lëshuara nga Ambasada Italiane.
52. Komisioni ka theksuar: “Referuar procesverbalit të mbajtur më datë 21.02.2018, gjatë marrjes së dëshmisë shtetasit {***}., iu kërkua dokumentacion provues mbi burimin e të ardhurave të

dhëna hua subjektit të rivlerësimit. Nga ana e z. {***}, u deklarua se ai nuk ka qenë i regjistruar pranë organeve tatimore. Pyetjes se a ka paguar tatime, ai i përgjigjet “jo”, duke deklaruar se përveç dokumentacionit bankar nuk ka asnjë dokumentacion tjetër për të provuar të ardhurat e tij”. Pavarësisht pretendimeve të z. {***} për të marrë prova mbi hyrje-daljet e tij drejt shteteve të ndryshme me qëllim kryerje aktiviteti tregtar dhe dokumentacion për zhdoganimet e automjeteve dhe akteve të shitjes së tyre, ato akte në çdo rast nuk do të provonin për Komisionin pagimin e detyrimeve tatimore, kërkesë taksative kushtetuese dhe ligjore për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara. Pra, për Komisionin, deklarimi i vetë personit tjetër të lidhur, z. {***}, që nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore dhe që nuk ka paguar detyrimet tatimore, ka qenë i mjaftueshëm për të arritur nivelin e provueshmërisë për ligjshmërinë ose jo të të ardhurave të dhëna hua prej tij subjektit të rivlerësimit.

53. Komisioni i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrës Kombëtare të biznesit, sipas shkresave të sipërcituara, për të verifikuar nëse personi tjetër i lidhur ka ushtruar aktivitet tregtar, siç parashtrohet më sipër nga trupi gjykues në paragrafin 27.
54. Në rastin në fjalë, personi tjetër i lidhur z. {***}, ashtu siç e ka pohuar edhe vetë gjatë dëshmisë së tij, ka deklaruar se ka ushtruar aktivitet tregtar duke siguruar të ardhura. Z. {***}, sipas dëshmisë së tij në Komision, ka kryer pagesa doganore në bazë peshe⁹ apo të vlerës së zhdoganimit për automjete, me një numër identifikimi të përgjithshëm, duke qenë se ai ka ushtruar aktivitet të paregjistruar në organet tatimore. Trupi gjykues vëren se ky numër identifikimi përdoret nga Dogana për të gjithë individët të cilët nuk kanë për qëllim ushtrimin e një aktiviteti tregtar, por që gjatë kalimit në doganë deklarojnë mallra për të cilat duhet të bëhen zhdoganime apo pagesa për ngarkesa mbi një vlerë apo peshë të caktuar. Përdorimi i këtij numri identifikimi të përgjithshëm, si dhe pagesa e taksës doganore për veshjet apo mobiliet e përdorura, apo e taksës për zhdoganim apo TVSH për automjetet, nga personi tjetër i lidhur, z. {***}, nuk i bën të ardhurat e realizuara nga këto shitje të mallrave të importuara të ligjshme¹⁰, për rrjedhojë edhe burimin e krijimit të pasurisë të ligjshme. Në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave ligjore të sipërcituara të ligjit nr. 84/2016, konsiderohen si pasuri të ligjshme të ardhurat që janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit apo personi tjetër i lidhur në këtë rast, dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi.
55. Pohimi i personit tjetër të lidhur z. {***}, i shtjelluar më sipër, se ai nuk ka qenë i regjistruar dhe nuk ka paguar asnjë detyrim tatimor sipas legjislacionit në fuqi për aktivitetin tregtar, i cili ka shërbyer për krijimin e pasurisë në shumën prej 28.500 eurosh, vërteton se ai nuk ka të ardhura të ligjshme në kuptim të legjislacionit të rivlerësimit, pra nuk justifikon ligjshmërinë e burimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, edhe subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, por edhe me ankimin e paraqitur në Kolegj nuk ka arritur të provojë pagimin e detyrimeve tatimore nga z. {***} në cilësinë e tregtarit, në mënyrë që të justifikojë

⁹ Për shitjen e veshjeve dhe mobilieve të përdorura.

¹⁰ Për më tepër, kur ato janë deklaruar se janë importuar jo për qëllime tregtare por për qëllime personale, siç është deklaruar nga personi tjetër i lidhur, z. {***}, në rastin e importit të automjeteve.

ligjshmërinë për shumën prej 28.500 eurosh të marrë hua prej tij, për krijimin e pasurisë apartament banimi në rr. {***}, Tiranë.

56. Trupi gjykues në përfundim vlerëson se faktet e vlerësuara nga Komisioni për këtë qëllim janë tërësore dhe kanë përmbushur kushtin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, për rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha se Komisioni nuk ka arsyetuar dhe nuk ka bërë verifikim të plotë të deklarimeve dhe të personit tjetër të lidhur, për ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 28.500 euro, është i pabazuar. Trupi gjykues vlerëson se z. {***} si person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 28.500 eurosh.
57. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit se “ekziston një mospërputhje midis shumës së të ardhurave dhe shpenzimeve të z. Hoxha për vitin 2011”. Shpenzimet janë më të larta se të ardhurat për këtë vit, në masën 1.752.123 lekë, dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të arsyeshme.
58. Sipas subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha, Komisioni ngatërron nocionin e “të ardhurave” sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi norma ligjore që të referon te pagesave e detyrimeve tatimore, në fakt bën fjalë dhe aplikohet në rastin e realizimit të “fitimit”, rast për të cilin individit shites duhet të paguajë tatim në burim si detyrim tatimor. Duke vijuar, ai thekson se bëhet fjalë për shitjen tek individë të tretë, të të gjitha sendeve dhe orendive shtëpiake, me një çmim më të ulët dhe, në këtë rast, është e qartë se arsyetimi i Komisionit që të ardhurat që mund të realizohen nga shitja e sendeve dhe orendive shtëpiake, të përdorura e të amortizuara, nuk mund të jenë të ligjshme pasi nuk është paguar detyrim tatimor për to është jo i bazuar dhe nuk mund të përbëjë shkakun për shkarkimin nga detyra.
59. Subjekti i rivlerësimit pretendon që konstatimi i Komisionit se diferenca e krijuar në vitin 2011 në shumën 1.752.123 lekë është rrjedhojë e shpenzimeve për mobilimin e apartamentit të ri në Tiranë në vlerën 2.500.000 lekë, me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, për të njëjtin vit, është i gabuar.
60. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kryer arredimin e apartamentit në rr. {***} Tiranë, si dhe shuma prej 1.752.123 lekësh është e pajustificuar me të ardhurat nga paga, huamarrja e deklaruar dhe kursimet e mbartura. Në datën 20.03.2018, me rezultatet e hetimit paraprak në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën lidhur me diferencën e konstatuar midis situatës financiare reale dhe asaj të deklaruar në deklarin periodik të pasurisë për vitin 2011.
61. Trupi gjykues, për këtë shkak ankimi ka vlerësuar faktet që rezultojnë nga: i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë “vetting” 2017; ii) deklaratat periodike të dorëzuara në ILDKPKI sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016; iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; dhe v) shpjegimet e përfaqësuesit ligjor në seancë dëgjimore; si dhe vi) shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në ankimin e paraqitur në Kolegj kundër vendimit të Komisionit nr. 18, datë 10.05.2018.

62. Në lidhje me shumën 1.752.123 lekë, të krijuar si rezultat i shitjes së orendive shtëpiake të apartamentit në Shkodër, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha ka paraqitur qëndrime të ndryshme: në shpjegimet për rezultatet e hetimit paraprak ai pretendon se orenditë janë shitur gjatë periudhës 2011-2012, në seancë dëgjimore avokati është shprehur po kështu, ndërsa në ankim pretendohet se shitjet e orendive janë kryer gjatë periudhës 2011-2014. Në deklaratimet periodike të pasurisë gjatë gjithë kësaj periudhe, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhura nga shitja e orendive shtëpiake, duke kryer fshehje të të ardhurave në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për shitjen e orendive shtëpiake, megjithëse shumica e pretenduar e përfituar nga shitja e tyre është e konsiderueshme edhe nëse pretendohet se është përfituar e shpërndarë në 4 vite.
63. Përkundër argumentit të subjektit të rivlerësimit se diferenca në vlerën 1.752.123 lekë është krijuar vetëm nga deklarimi i tij i njëanshëm se ka kryer shpenzime mobilimi për apartamentin e ri në rr. {***} Tiranë, në vlerën 2.500.000 lekë, nga fashikulli i çështjes, Kolegjit i rezultoi se provuar se në përgjigje të pyetësorit të përgjithshëm të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha, për pyetjet 6 dhe 11, është përgjigjur si vijon:
- “[...] Pas blerjes së banesës në vitin 2011 kam bërë shpenzime për arredimin e saj në shumën rreth 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, që përfshin mobilim, sistem ngrohje, kondicioner, shtrim parketi, pajisje elektroshtëpiake [...]”
64. Më tej, në datën 02.02.2018, Komisioni i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit kërkesën si vijon:
- “[...]5. Në përgjigje të pyetësorit që na keni dërguar, ju keni deklaruar se: “[...] pas blerjes së banesës në vitin 2011, kam bërë shpenzime për arredimin e saj në shumën rreth 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë [...]”. Ju lutemi na vini në dispozicion dokumentacionin që provon blerjet e bëra për mobilim, sistem ngrohje etj. [...]”
65. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e tij për këtë kërkesë të Komisionit ka sqaruar se:
- “[...] Për pajisjet e blera në lidhje me arredimin e banesës aktualisht nuk disponoj asnjë dokumentacion blerje, pasi ky dokumentacion është ruajtur për efekt të afatit të garancisë së mallrave të blera (afati 2- apo 3-vjeçar). Mobilimin e shtëpisë ma ka bërë një person me emrin {***} (mbiemri nuk më kujtohet), por që qendrën e punës e kishte në {***}. Parketin e ka blerë kunati im, {***}, në Shkodër. Shtrimin e parketit e ka bërë {***} (djali i dajës) që banon në {***}, Tiranë. Pajisjet mund të jenë blerë në dyqanet Globe (rruga e Kavajës) apo Neptun (ish-Casa Italia) [...]”
66. Në rezultatet e hetimit paraprak, përcjellë subjektit të rivlerësimit në datën 20.03.2018, në tabelën ku analizohet situata financiare e vitit 2011, përmbahet shprehimisht edhe shpenzimi i shumës prej 2.500.000 lekësh për mobilimin e apartamentit të ri të banimit në rr. {***}, Tiranë¹¹ për atë vit. Më tej, edhe vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e dërguara mbi këto rezultate

¹¹ Tabela në faqen 2 e rezultateve të hetimit paraprak, datë 20.03.2018.

të hetimit paraprak, konkretisht përgjigjet me shkrim të datave 4, 10, 11, 20 dhe 26 prill 2018, në asnjë rast nuk e ka kundërshtuar vendosjen e këtij shpenzimi vetëm në një vit – në vitin 2011. Edhe më tej në seancën publike gjyqësore në Komision, as përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit nuk rezulton nga procesverbali i seancës së datës 07.05.2018 ta ketë kundërshtuar kryerjen e shpenzimit prej 2.500.000 lekësh për arredimin e apartamentit të ri vetëm brenda vitit 2011.

67. Si rrjedhojë, pavarësisht nga detyrimi ligjor që kishte, por edhe kërkesës së paraqitur nga Komisioni¹², subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë me dokumentacion justifikues kryerjen e këtij shpenzimi për arredimin e apartamentit të ri. Për këtë arsye, Komisioni ka konkluduar bazuar në vlerën e deklaruar prej tij.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se deklarimet periodike të pasurisë të bëra nga subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha për periudhën 2010-2012, janë bërë duke fshehur të ardhurat e realizuara nga shitja e orendive shtëpiake të shtëpisë së vjetër, duke vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrim ligjor pasqyrimin e këtyre të ardhurave në këto deklarime. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në situatën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2011.

68. Trupi gjykues konstaton se sipas treguesve financiarë që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, në vitin 2011, vlera prej 1.752.123 lekësh, pjesë e totalit të shpenzimeve dhe pagesave të këtij viti, nuk justifikohet nga të ardhurat nga paga, huamarrja e deklaruar dhe kursimet e mbartura.

69. Në përfundim, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se shpjegimet e sjella nga subjekti i rivlerësimit për të justifikuar mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në shumën prej 1.752.123 lekësh, për vitin 2011, nuk kanë përmbushur kriteret e pikës 3 të nenit D të Kushtetutës, që përcakton: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave”. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

70. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme diferencat e shumave të deklaruara si kursime për vitin 2011 në shumën 1.752.123 lekë. Për sa më sipër, pretendimet e tij janë të pabazuara.

71. Subjekti i rivlerësimit pretendon që vlerësimi i Komisionit se ka fshehur duke mos deklaruar shumën prej 330.000 lekësh, gjendje në llogarinë depozitë të bashkëshortes pranë BKT, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, është jo i drejtë. Ai pretendon se rezulton e provuar tej çdo dyshimi fakti se kemi të bëjmë me një lapsus e harresë materiale në deklarimin e vitit përkatës. Sipas ankuesit, në kushtet e një ligji dhe detyrimi të ri, kryerja e një lapsusi të tillë ka

¹² Sipas *e-mail*-it të datës 02.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

qenë një veprim i cili është korrigjuar pa asnjë pasojë, menjëherë në vitin pasardhës 2004 e në vijim.

72. Rezulton e provuar që në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar llogarinë depozitë në lekë të bashkëshortes në BKT, me shumë të depozituara 330000 lekë, deri në datën 31.12.2003. Nëpërmjet postës elektronike, në datën 04.04.2018 subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet në përgjigje të rezultateve të hetimit paraprak, sipas të cilave ai sqaronte se viti 2003 ka qenë viti i parë i deklarimit të pasurisë, dhe mosdeklarimi i depozitës së bashkëshortes në deklarimin e këtij viti ka qenë një lapsus, i cili është korrigjuar në deklaratën e vitit 2004 duke dhënë detaje për shumatat e depozituara dhe vitin.

73. Bazuar në përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 32, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit (*vetting*) nuk është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit, por deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë prej tij. Deklarimet e mëparshme të pasurisë, të kryera nga subjekti i rivlerësimit, përbëjnë edhe bazën e vlerësimit krahasues për ILDKPKI-në, për përgatitjen e raportit përfundimtar, bazuar në nenin 33, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton:

“1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklarimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative [...]”.

74. Bazuar në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni heton në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes dhe kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi pa u bazuar dhe pa qenë i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja. Në këtë kuptim, Komisioni përdor të njëjtën bazë vlerësimi si ILDKPKI-ja: deklaratën e pasurisë “vetting” 2017 të krahasuar me deklaratat periodike të pasurisë ndër vite, të subjektit të rivlerësimit.

75. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklarimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit. Në këtë proces subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet janë informuar mbi sanksionet në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), e cila ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor. Në lidhje me deklarimin e pasurisë, ligji nuk ka pasur në qëllim të tij përcaktimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese, të lidhura me dashjen apo qëllimin, pasi në të kundërt do të kishte bërë përcaktime të tilla, si në nenin 38 për standardet e kontrollit të figurës.

76. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, shkarkimi i gjyqtarit, ashtu si në rastet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, kryhet nga Komisioni pas një procesi hetimi të bazuar në prova, të cilat sipas nenit 32, pika 4 mund të jenë edhe deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja. Kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, i shërben Komisionit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij.
77. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të shumës prej 330.000 lekësh në deklaratën e tij të pasurisë për vitin 2003, gjendje e depozitës së bashkëshortes së tij në llogarinë pranë BKT, në kundërshtim me nenin 61, pika 3 dhe nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
78. Subjekti i rivlerësimit, për pjesën që i përket vlerësimit të aftësive profesionale, kundërshton vlerësimin e Komisionit, sipas të cilit “subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.” Sipas ankuesit, pavarësisht se ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar objektin dhe burimet për realizimin e këtij vlerësimi nga organet e përcaktuara prej tij, në rastin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ato mund të gjejnë zbatim për aq sa zbatohen në procedurat dhe rregullat e gjykimit kushtetues, dhe për sa nuk bien ndesh me rregullimet e ligjit organik nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.
79. Në lidhje me konstatimin se vendimi i arsyetuar i Gjykatës Kushtetuese nr. 58, datë 10.04.2015, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues në këtë gjykim, është marrë me shumicë votash dhe subjekti i rivlerësimit/ankues, ka qenë në pakicë, sikurse rezulton nga procesverbali i votimit¹³. Këtij vendimi të marrë me shumicë votash nuk i është bashkëngjitur mendimi i pakicës. Ankuesi kundërshton argumentet e Komisionit në vendimin objekt ankimi, me kundërgargumentin se dispozita kushtetuese e nenit 132, është zbrëthyer sipas nenit 72 të ligjit nr. 8577/2000 dhe, bazuar në këtë nen, sipas tij, gjyqtari që mbetet në pakicë **“ka të drejtë”** të arsyetojë mendimin e tij që i bashkohet vendimit dhe botohet bashkë me të, dhe se arsyetimi i mendimit në pakicë nuk është detyrim për gjyqtarin, por një e drejtë e tij.
80. Trupi gjykues vëren se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk e njeh “të drejtën” e mosarsyetimit të mendimit të pakicës. Neni 132, pika 2 e Kushtetutës përcakton: “[...] Mendimi i pakicës botohet bashkë me vendimin”, ndërkohë që neni 72, pika 8 e ligjit nr. 8577/2000, përcakton: “[...] Gjyqtari që mbetet në pakicë ka të drejtë të arsyetojë mendimin e tij që i bashkohet vendimit dhe botohet bashkë me të. [...]”
81. Kolegji vlerëson se interpretimi i zgjeruar i pikës 8 të nenit 72 të ligjit nr. 8577/2000, që përpiqet të trajtojë arsyetimin e mendimit në pakicë si një “të drejtë” dhe jo detyrim bie ndesh me dispozitën kushtetuese e cila, për kontrast, nuk e njeh mosarsyetimin e mendimit në pakicë, por detyron gjykatën dhe gjyqtarin të shoqërojnë deri në botim vendimin së bashku me

¹³ Subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha ka votuar kundër.

mendimin e pakicës. Ky lexim i ligjit dhe praktika gjyqësore sugjerojnë që gjyqtari i mbetur në pakicë gëzon të drejtën të votojë kundër, por jo “të drejtën” të mos arsyetojë mendimin e tij.

82. Në lidhje me konstatimin se vendimet janë arsyetuar me vonesë për çështjet nr. A-12 prot., datë 3.05.2013, që i përket kërkuesit {***}. (1 vit e 1 muaj) dhe P-5, datë 25.03.2014, që i përket kërkuesit {***} (7 muaj e 17 ditë), ankuesi kundërshton se e gjithë procedura e arsyetimit, diskutimit, redaktimit dhe përgatitjes për shpallje të vendimit kërkon një kohë të caktuar, e cila nuk është e përcaktueshme për sa kohë që nuk ka asnjë detyrim apo rregullim ligjor taksativ në lidhje me këtë fazë. Duke mos pasur procedura dhe afate ligjore të përcaktuara në lidhje me këtë pjesë të procesit, vijon subjekti i rivlerësimit, vetë rregullorja ia ka lënë Mbledhjes së Gjyqtarëve kompetencën për të vendosur në lidhje me strukturën dhe kohën e përgatitjes së vendimit dhe është ky organ që mund të vlerësojë nëse ky afat është respektuar. Sipas subjektit të rivlerësimit: “Çdo referim tjetër në akte ligjore që rregullojnë procedura të ndryshme gjykimi nga ai kushtetues që përcaktojnë afate ligjore që nuk gjejnë zbatim në këtë lloj gjykimi apo që përcaktojnë detyrime për gjyqtarin e zakonshëm gjatë ushtrimit të funksionit të tij, nuk mund të pranohet në rastin e gjyqtarëve kushtetues”.
83. Trupi gjykues vlerëson gjithashtu se është vetë neni 1, pika 2 e ligjit nr. 8577/2000 që përcakton: “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën e çështjes”, dhe për këtë arsye llogaritja e afateve të arsyeshme të gjykimit kushtetues duhet të vlerësohet edhe në këndvështrimin e procedurave të tjera.
84. Në lidhje me kohëzgjatjen e procesit, ankuesi pretendon se të gjitha ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile (ligji nr. 38/2017) i referohen gjykimit në gjykatat e zakonshme dhe ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore efektive me qëllim që individit t’i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm apo edhe ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Sipas ankuesit, mungesa e parashikimit të afateve në lidhje me kohëzgjatjen e procesit para kësaj gjykate nuk përbën delegim për referim në ligje të tjera, për sa kohë që edhe në raste të veçanta sipas pikës 2, të nenit 1 të ligjit nr. 8577/2000 është vetë gjykata që vlerëson nëse ka vend për të marrë parasysh dispozita të tjera në varësi të natyrës së çështjes.
85. Trupi gjykues i Komisionit ka konstatuar se në çështjen në Gjykatën Kushtetuese nr. P-5 prot., datë 25.03.2014, regjistrimi që i përket kërkuesit P.B. dhe subjektit të interesuar Prokuroria e Përgjithshme, me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 203, datë 12.06.2013, të Gjykatës së Lartë”, përfunduar me vendimin nr. 35, datë 1.06.2015, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 6 ditë. Ndërsa nga data e marrjes së dosjes nga relatori, më datë 26.03.2014, gjykimi ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 5 ditë. Te kjo kohëzgjatje ka ndikuar koha e paarsyeshme për shpalljen e vendimit gjyqësor, që ka cenuar procesin e rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.
86. Trupi gjykues vlerëson të drejtë vlerësimin e Komisionit se, pavarësisht mospërcaktimit nga ligji i kohës së një afati për arsyetimin e vendimit, arsyetimi i vendimit pas 1 viti, 1 muaji e 11 ditësh, cenon standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe

nenit 6 të KEDNJ. Në tri rastet e tjera, vendimi gjyqësor është shpallur pas 7 muajve e 17 ditëve nga marrja e tij, pas 3 muajve e 7 ditëve dhe pas 1 muaji e 21 ditëve. Natyra e çështjeve që shqyrtohen në Gjykatën Kushtetuese dhe roli i rëndësishëm i Gjykatës Kushtetuese si garantuesja e procesit të rregullt, pavarësisht mungesës së afateve fikse ligjore për përfundimin e gjykimeve, parë në kontekstin e mjeteve efektive në GJEDNJ për individët, arsyetimi i vendimit nga Gjykata Kushtetuese brenda një afati të arsyeshëm merr një rëndësi tejet të veçantë. Parimi: “Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”, merr rëndësi të veçantë në këtë kontekst.

87. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se me ndryshimet e fundit të ligjit nr. 8577/2000 (ligji nr. 99/2016), në pikën 2 të nenit 1 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, janë shtuar fjalët “apo rregullorja e Gjykatës Kushtetuese“. Edhe vetë ndryshimet rishtazi të ligjit organik nuk e kanë konsideruar gjykimin kushtetues tërësisht të shpëputur dhe të pavarur nga procedurat e tjera, për aq kohë sa vetë ligji organik nuk ka një përcaktim të shprehur. Shprehimisht, neni përcakton: “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj apo nga rregullorja e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozita ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes”.
88. Trupi gjykues çmon të drejtë përfundimin e arritur nga trupa gjyqësore e Komisionit, se në bazë të të gjithave rrethanave dhe kushteve të mësipërme, parregullsitë e konstatuara në organizim nuk janë të asaj natyre dhe asaj shkalle, saqë të cenojnë aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe të mund të cilësohen në një vlerësim me mangësi të rivlerësimit në përgjithësi në kuptimin dhe në nivelin që e kërkon ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
89. Bazuar në sa u argumentua më sipër, trupi gjykues vlerëson se Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 18, datë 10.05.2018, është marrë në bazë të një shqyrtimi të plotë dhe të gjithanshëm të akteve, një analize të plotë të fakteve juridike dhe financiare, si dhe provueshmërisë së plotë të tyre në përputhje me përcaktimet e neneve 33, 45, 52 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016.
90. Trupi gjykues pasi analizoi shkaqet e ankimit, lidhur këto me provat e administruara në këtë çështje, për subjektin e rivlerësimit Fatmir Hoxha, rezulton se ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë sepse:
- i) ka deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën “vetting” 2017 nuk është deklaruar si burim huaja e marrë shtetasit {***}, në vlerën prej 28.500 eurosh;
 - ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua shtetasit {***}, në vlerën prej 28.500 eurosh;
 - iii) ka mospërputhje midis shumës së të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2011 në masën që shpenzimet tejkalojnë të ardhurat me 1.752.123 lekë, shumë e cila nuk është shpjeguar në mënyrë të arsyeshme.

iv) subjekti i rivlerësimit ka fshehur duke mos e deklaruar shumën prej 330.000 lekësh, gjendje në llogarinë depozitë të bashkëshortes pranë BKT, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.

91. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji, për sa i përket masës disiplinore të dhënë nga Komisioni me vendimin nr. 18, datë 10.05.2018, çmon se ky vendim duhet lënë në fuqi.

Për sa më sipër Kolegji, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha është në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016,

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbështetur në faktet e provuara në gjykim dhe në ligjin e zbatueshëm për çështjen, si dhe bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 18, datë 10.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Fatmir Hoxha.
2. Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.
3. U shpall sot në Tiranë, më datë 25.09.2018.

ANËTARE

ANËTAR

ANËTARE

Natasha MULAJ

Luan DACI

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

nënshkrimi

nënshkrimi

**RELATORE E
ÇËSHTJES**

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES

Ina RAMA

Albana SHTYLLA

nënshkrimi - kundër

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, ndërsa bashkohem me vendimin e shumicës datë 25.09.2018, nr. 7/2018 (JR), që la në fuqi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha (nr. 18, datë 10.05.2018), më poshtë parashtroj mendimin tim paralel lidhur me njërin prej shkaqeve të ankimit të subjektit.

Më konkretisht, për sa i përket konstatimit “iv” të “fshehjes, duke mos deklaruar shumën prej 330000 lekësh, gjendje në llogarinë depozitë të bashkëshortes¹⁴” në deklaratën vjetore të vitit 2003, vlerësoj që:

a) Fakti që subjekti e ka kryer vetë korrigjimin në deklaratën pasardhëse të vitit 2004, duhet të ishte marrë parasysh nga Komisioni në hetimin dhe vendimmarrjen e këtij të fundit, parë nën dritën e legjislacionit të kohës, ligjit 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë.” Zbatimi prapaveprues i dispozitave të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 nga Komisioni vlerësoj se është i gabuar.

b) Në vlerësimin nëse zbatohen dispozitat e nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës, i cili, përveç të tjerave, fshehjen dhe deklarimin e pasaktë e lidh automatikisht me prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit, Komisioni duhet të lexonte dhe zbatonte nenin 32, paragrafi 5 i ligjit nr. 84/2016 në mënyrë harmonike me vetë atë dispozitë, por edhe me rivlerësimin e pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve në kontekstin e *vetting*-ut si një moment i ri institucional. Në këtë lexim, deklarata e pasurisë, dhënë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, dhe pasojat që sjellin për subjektet e rivlerësimit deklarimet e kryera në kushte pasaktësie, fshehjeje apo mashtrimi, ka marrë nga ligjvënësi një peshë të ndryshme, herë pas here edhe vendimtare, në përcaktimin nëse subjektet e rivlerësimit prezumohen të jenë në kushtet e masës disiplinore të shkarkimit. Në këtë këndvështrim dhe duke pasur parasysh risinë dhe karakterin tejet të veçantë të procesit të rivlerësimit, Komisioni duhet të përdorë deklarimet e mëparshme si prova rrethanore, për të provuar ose përjashtuar deklarimet e bëra sipas ligjit nr. 84/2016, dhe jo e anasjella. Në kontekstin e rivlerësimit, një korrigjim vullnetar nga vetë subjektet, duhet të vlerësohej pozitivisht.

GJYQTARE

REZARTA SCHUETZ

nënshkrimi

¹⁴ Faqja 11, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit: <http://kpk.al/wp-content/uploads/2018/06/Vendim-Fatmir-Hoxha.pdf>.

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, kam votuar kundër vendimit nr. 7, datë 25.09.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha, kundër vendimit nr. 18, datë 10.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra e subjektit, me detyrë gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.
2. Vendimi nr. 18, datë 10.05.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) në përfundim të procedurës së rivlerësimit ka konkluduar se subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha duhet t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në zbatim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", duke u mbështetur në shkaqet e shkarkimit si më poshtë:
 - i) *Ka deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për burimin e krijimit të pasurisë, apartament 112 m² në rrugën "{***}" Tiranë, pasi në deklaratën e pasurisë "vetting" 2017 nuk është deklaruar si burim huaja e marrë shtetasit {***}, në vlerën prej 28.500 eurosh.*
 - ii) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua shtetasit {***}, në vlerën prej 28.500 eurosh, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.*
 - iii) *Ka mospërputhje midis shumës së të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2011 në masën që shpenzimet tejkalojnë të ardhurat me 1.752.123 lekë, shumë e cila nuk është shpjeguar në mënyrë të arsyeshme.*
 - iv) *Subjekti i rivlerësimit ka fshehur duke mos e deklaruar shumën prej 330.000 lekësh, gjendje në llogarinë depozitë të bashkëshortes pranë BKT-së në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.*
3. Kundër vendimit të mësipërm subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim duke kundërshtuar vendimin e Komisionit për shkaqet e mëposhtme.
 - 3.1 *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i deklarimit ka deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 112,36 m², në lidhje me huan prej 28.500 eurosh, të dhënë nga shtetasi {***}, është i pambështetur në ligj, pasi subjekti nuk ka pasur detyrimin të deklaronte këtë hua në deklaratën "vetting" 2017 duke qenë se ajo ishte shlyer në vitin 2014 dhe ky fakt ishte deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2015.*
 - 3.2 *Konkluzioni i Komisionit, i parashtruar në vendim, se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua shtetasit {***}, në vlerën 28.500 euro, është i padrejtë pasi për këtë gjetje subjektit nuk i ka kaluar barra e provës nga ana e Komisionit, duke i mohuar në këtë mënyrë mundësinë dhe të drejtën për t'u mbrojtur dhe për të justifikuar këtë burim.*
 - 3.3 *Në vazhdim të shkakut të mësipërm, kërkohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit të merren provat e reja bashkëlidhur ankimit, të cilat justifikojnë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur me z. {***} dhe të analizohet kompetenca e KPK-së për hetim lidhur me të.*
 - 3.4 *Konkluzioni i Komisionit se ka një diferencë të pajustificuar mes të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit për vitin 2011, në masën prej 1.752.123 lekësh është i gabuar dhe, duke mos marrë parasysh deklaratimet e subjektit për shtrirjen në më shumë se një vit të shpenzimeve të kryera për mobilimin e shtëpisë, si edhe duke mos konsideruar në*

këtë shpenzim vlerën e nxjerrë nga shitja e orendive të përdorura të shtëpisë së banimit që subjekti kishte në qytetin e Shkodrës. Brenda këtij shkaku, subjekti kundërshton edhe argumentin se për sendet e përdorura nuk rezulton të jetë paguar tatim fitimi, duke pretenduar se shitja e tyre nuk kishte prodhuar ndonjë vlerë të shtuar mbi vlerën e tyre fillestare, e cila do të mund të tatohej sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

- 3.5 *Konkluzioni i Komisionit se mosdeklarimi për shkak të harresës i një llogarie të bashkëshortes (nr. {***}) pranë BKT) në deklarin fillestar të 2003-shit nuk përbën shkak për fshehje pasurie, pasi po kjo llogari është deklaruar si në deklaratën vijuese të deklarin të të ardhurave dhe interesave të vitit 2004, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë “vetting” 2017.*
- 3.6 *Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e aftësive profesionale, metodologjinë dhe bazën ligjore të përdorur për vlerësimin e subjektit është i pasaktë dhe jo i mbështetur në kornizën ligjore mbi të cilën do duhej të bëhej ky vlerësim, duke qenë se subjekti është anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe jo i sistemit të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor . Përfundimisht, subjekti kërkon ndryshimin e vendimit nr. 18, datë 10.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Fatmir Hoxha, me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.*

Në verifikim të shkaqeve të ngritura në ankim në raport me vendimmarrjen e Komisionit dhe procedurën e ndjekur prej tij, gjithashtu edhe në cilësinë e gjyqtarës relatores kam konstatuar se gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioni ka pasur shkelje të rëndësishme të drejtave të subjektit lidhur me dhënien e së drejtës për t’u njohur me rezultatet e hetimit, si edhe me shkaqet që prezumojnë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, të cilat në tërësinë e tyre, në vlerësimin tim, kanë çuar në zhvillimin e një procesi të parregullt e në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Liritë Themelore të Njeriut, duke afektuar në këtë mënyrë, ndër të tjera, në thelb vendimmarrjen e Komisionit dhe duke prodhuar marrjen e një vendimi të padrejtë për sa i përket shkarkimit të tij për shkaqet e cituara në pjesën hyrëse të këtij mendimi. Përpos konstatimit të shkaqeve të ankimit që konsiderohen si shkaqe që kanë të bëjnë me procesin e rregullt, mendoj se edhe vendimmarrja e Komisionit, e cila del jashtë afektimit prej këtyre shkaqeve, është marrë në zbatim të gabuar të dispozitave kushtetuese e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, i gjithë vendimi i Komisionit që konstaton se subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha ka bërë deklarin të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 është i gabuar dhe, si i tillë, duhej të ndryshohej nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të subjektit të rikthehej në detyrë për shkak të revokimit të masës së pezullimit nga detyra, e vendosur *ex lege* si pasojë e shkarkimit.

4. Vota kundër qëndrimit të shumicës është e lidhur me dy aspekte, njëri i natyrës procedurale që i përket formës së gjykimit të çështjes, kurse tjetri për vendimmarrjen përfundimtare të Kolegjit, e cila pjesërisht është konsekuencë e qëndrimit për formën e gjykimit.

Në lidhje me çështjen e parë, mbështetur në shqyrtimin e pretendimeve të subjektit të paraqitura në ankim, kam votuar *pro* kalimit për shqyrtim të çështjes në seancë gjyqësore me qëllim marrjen në shqyrtim të provave të reja të paraqitura nga subjekti bashkë me ankimin, si edhe për të përcaktuar qartë e plotësisht situatën faktike që lidhet me shpenzimin e shumës prej 2.500.000 lekësh për mobilimin e shtëpisë së subjektit.

Në funksion të kësaj vendimmarrjeje, janë identifikuar prej meje disa çështje të cilat pas analizës faktike e ligjore më kanë çuar në konkluzionin e mësipërm. Këto çështje renditen si më poshtë:

- 4.1 Nëse ka pasur trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit detyrimin të kalojë barrën e provës te subjekti i rivlerësimit në lidhje me një proces që përbën detyrim ligjor në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
- 4.2 Nëse ia ka kaluar subjektit të rivlerësimit, z. Fatmir Hoxha, barrën e provës në rastin konkret, për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. {***}.
- 4.3 Nëse gjendej trupa gjykuese e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit para rasteve të parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim ligji nr. 49/2012) për sa i takon kërkesës për marrjen e provave të reja.
- 4.4 Nëse kishte elemente të tjera në çështje që kanë çuar në një konstatim jo të plotë e të saktë të gjendjes faktike, të cilat për pasojë do të kenë nevojë të sqarohen e plotësohen nëpërmjet shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palës në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.
5. Në lidhje me çështjen e parë (4.1) kam çmuar se dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë e duhet të konsiderohen për t’i dhënë zgjidhje janë:
- i. Neni “Ç”, paragrafi i katërt i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: “Komisioni ose Kolegji i Apelimit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, komisionerit publik ose vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve”.
 - ii. Neni “D”, paragrafi i pestë i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”
 - iii. Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.”
 - iv. Neni 45 i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “[...] Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit [...]”
 - v. Neni 51 i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Në rast se subjekti i rivlerësimit nuk paraqet provat, sipas nenit 85 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe kur provat që disponojnë janë të paplota, Komisioni ose Kolegji i Apelimit mund të vendosin bazuar në provat që disponojnë, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e tyre të brendshme.”
 - vi. Neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelimit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.”
 - vii. Neni 55, paragrafi i parë i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Komisioni fton subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative [...]”

- viii. Neni 87, paragrafët 1 dhe 2, germa “ç” e Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon: “1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64 i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar. 2. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me shkrim apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna [...] ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës [...]”
6. Në analizë të kuadrit ligjor të cituar më lart dhe të çështjes që u shtrua për zgjidhje në këtë fazë, mendoj se fryma e normës kushtetuese dhe e atyre të ligjit nr. 84/2016 është e orientuar drejt një roli aktiv të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me hetimin dhe marrjen e të gjitha të dhënave që çmohen të nevojshme për të bërë një vlerësim të plotë e të gjithanshëm të komponentëve të rivlerësimit. Në kuptim të funksioneve dhe detyrave që kanë këto organe, vlerësoj se është brenda kompetencës së tyre që të investigojnë dhe të marrin çdo të dhënë të nevojshme për hetimin me qëllim arritjen e një konkluzioni të mbështetur në prova të mbledhura në përputhje me ligjin. Ky detyrim i Komisionit në vlerësimin tim, në kuadër të një procedure me natyrë publike, prevalon në raport me detyrimin e subjektit për të provuar elementet e përcaktuara prej ligjit, në kuptimin që pavarësisht detyrimit të subjektit, Komisioni nuk mund të qëndrojë pasiv dhe të kryejë një hetim të paplotë, veçanërisht në rastet kur çmohet se momente të caktuara që lidhen me rivlerësimin duhen sqaruar plotësisht.
 7. Në këto raste, Komisioni, kur konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka ezauruar detyrimin e tij ligjor për të provuar fakte të caktuara, duhet t’ia bëjë me dije këtë mangësi apo situatë subjektit, nëse ky element konsiderohet se mund të çojë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit, në mënyrë që subjekti i rivlerësimit të ketë mundësi të realizojë detyrimin ligjor, si edhe të dëgjohet e mbrohet në kuadër të një procesi të rregullt në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e nenit 6 të KEDNJ.
 8. Aneksi i Kushtetutës, neni “Ç”, paragrafi i katërt përcakton kompetencën e organeve të rivlerësimit, Komisionit e Kolegjit, të kryejnë një sërë veprimesh për të konfirmuar vërtetësinë e saktësinë e deklarimeve të subjekteve në procesin e rivlerësimit. Ky detyrim kushtetues, përcakton pikërisht funksionin investigativ të pavarur të organeve, funksion i cilësuar edhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit janë institucionet e *vetting*-ut ato që bëjnë rivlerësimin e subjekteve dhe marrin vendime të mbështetura në prova e bindjen e tyre të brendshme.
 9. Në vijim të kësaj dispozite kushtetuese, ligji nr. 84/2016, në nenin 45 të tij parashikon gjithashtu kompetencën e Komisionit e Kolegjit për të hetuar e vlerësuar të gjitha faktet e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Kjo kompetencë funksionale shkon dhe limitohet deri në kufirin kur provat arrijnë nivelin e provueshmërisë, sipas vlerësimit të Komisionit. Në këtë moment procedural, rregullimi i nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 e detyron Komisionin t’i kalojë barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e asaj që Komisioni çmon se provojnë provat e mbledhura prej tij.
 10. Në vlerësimin tim, kjo do të thotë që çdo herë që Komisioni, mbështetur në provat e mbledhura prej tij në funksion të shqyrtimit të vërtetësisë dhe saktësisë së deklaratës së subjektit, arrin në konkluzione se provohen disa fakte të cilat vijnë në kundërshtim me çfarë ka deklaruar subjekti dhe që krijojnë prezumimin ligjor se ndaj subjektit duhet të vendoset masë disiplinore, atëherë Komisioni është i detyruar t’i bëjë me dije subjektit këtë situatë ligjore, në mënyrë që ai të zbatojë detyrimin kushtetues për të provuar të kundërtën. Ky moment procedural mjaft i rëndësishëm, duhet të jetë i qartë dhe i komunikuar drejtpërdrejt subjektit të rivlerësimit, pikërisht në garantim të së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe për t’u mbrojtur e dëgjuar ndaj këtyre gjetjeve/akuzave që prezumojnë shkarkimin e tij nga detyra në zbatim të nenit D,

pika 5 dhe të nenit DH, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Qartësia e Komisionit në këto raste duhet të lidhet me komunikimin e plotë dhe të saktë të rrethanave që prodhojnë prezumimin ligjor në favor të masës disiplinore dhe jo të mjaftohet me përdorimin formal të termit “kalim i barrës së provës”.

11. Në mbështetje të këtij argumenti shkon edhe parashikimi i nenit 55, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i lidhur me parashikimet e nenit 87, pika 1 dhe pika 2, germa “ç” e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 44/2015). Neni 55, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se Komisioni thërret subjektin në seancë dëgjimore në përputhje me rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Administrative. Kjo do të thotë që përpara se Komisioni të thërrasë subjektin në seancë dëgjimore duhet të respektojë disa norma procedurale të Kodit të Procedurës Administrative.
12. Neni 87 i ligjit nr. 44/2015, i titulluar “Njoftimi dhe e drejta për t’u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar”, parashikon se organi publik përpara se të marrë vendimin përfundimtar njofton palën për të drejtën e saj për t’u dëgjuar. Ndër të dhënat që duhet të përmbajë ky njoftim, sipas paragrafit 2 të këtij neni, është edhe parashikimi i germës “ç” të tij, e cila detyron organin publik t’i bëjë prezent palës provat e administruara, rezultatet e hetimit si edhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës. Në zbatim të kuptimit të këtij rregulli, Komisioni duhet, para se t’i japë mundësinë të dëgjohet subjektit të rivlerësimit, t’i bëjë prezent përveç rezultateve të hetimit edhe “rezultatet e pritshme të procedurës administrative”, që do të thotë praktikisht t’i bëjë me dije se cila është situata e gjetjeve të Komisionit që mund të shkaktojnë shkarkimin nga detyra të subjektit. Pikërisht me komunikimin e këtyre fakteve, Komisioni ka kaluar praktikisht barrën e provës te subjekti i rivlerësimit, i cili ka në këto rrethana detyrimin kushtetues që të paraqesë prova për të provuar të kundërtën e asaj që ka konkluduar Komisioni nga hetimi i tij.
Në vijim, vetëm nëse subjekti nuk paraqet prova apo nuk reagon për të realizuar detyrimin e tij që lidhet me provueshmërinë siç parashikojnë nenet 84 e 85 të Kodit të Procedurës Administrative, atëherë Komisioni ka të drejtë që në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë duke u mbështetur në provat e mbledhura deri atë moment, në vlerësimin e çështjes në tërësi si dhe bindjen e tyre të brendshme.
13. Në konkluzion, gjykoj se detyrimi i Komisionit për të bërë prezente gjetjet e provueshme prej tij dhe njoftimin e tyre subjektit, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën, është një rregull që duhet të zbatohet në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.
14. Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për zgjidhje në paragrafin 4.2 më sipër, që lidhet me faktin nëse Komisioni ka kaluar ose jo barrën e provës te subjekti i rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë së personit të lidhur {***}, kam çmuar se analiza dhe zgjidhja e saj duhet t’u referohet akteve procedurale dhe të dhënave që gjenden të administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
15. Nga shqyrtimi i akteve procedurale të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, rezulton se trupa gjyquese me vendimin nr. 3, datë 19.03.2018, ka vendosur të përfundojë hetimin kryesisht dhe t’i kalojë subjektit barrën e provës për shtatë çështje të parashikuara në mënyrë të detajuar në Aneksin 2 që titullohet “Rezultatet e hetimit paraprak”.
16. Nga shqyrtimi i këtij akti, rezulton se në lidhje me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me personin tjetër të lidhur, z. {***}, është bërë vetëm një gjetje e cilësuar si çështja nr. 1 e këtij akti. Shprehimisht, në këtë pikë thuhet: “[...] Në deklaratën *vetting*, nuk keni deklaruar si një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie borxhin e marrë nga kunati juaj, z. {***}, ndërkohë që në përgjigje të pyetjes së drejtuar nga ana jonë citoni: Borxhi i marrë nga kunati im {***} në

shumën 28.500 euro, në shkurt 2011, ka qenë një nga burimet e përdorura për blerjen e apartamentit 2 + 1 të ndodhur në rrugën “{***}”, godina 8-katëshe, {***}, Tiranë”. Ky është i vetmi fakt i konstatuar prej trupës gjyquese si i tillë, që të çon drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore në lidhje me marrëdhënien e huas që subjekti i rivlerësimit ka pasur me personin tjetër të lidhur. Të gjitha çështjet e tjera të ngritura e për të cilat ka kaluar barra e provës janë jashtë sferës së kësaj çështjeje.

17. Më herët trupa gjyquese, sipas procesverbalit të datës 23.01.2018, rezulton se ka rënë dakord që të kontaktohet shtetasi {***} dhe t’i kërkohej të konfirmojë marrëdhënien e huas që ka pasur me subjektin dhe të paraqesë dokumentacionin që provon burimin e ligjshëm të kësaj pasurie. Rezulton se z. {***} është pyetur në lidhje me këto elemente në datën 21.02.2018 dhe ka deklaruar se konfirmon marrëdhënien e huas dhe gjithashtu është shprehur se të ardhurat e tij kanë si burim aktivitetin e tij të tregtisë me rroba të përdorura e automjete, të shtrirë në shumë vite, dhe se për këtë ai i sugjeron Komisionit të kërkojë të dhëna në dogana e sistemin TIMS sepse ai nuk i disponon për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar (bëhet fjalë për vitet 1994-2006).
18. Pas këtij veprimi procedural, nga analiza e akteve në dosje nuk rezulton që Komisioni t’i jetë kthyer më diskutimit të këtij argumenti në drejtim të vlerësimit të dëshmisë dhe të asaj që z. {***} ka thënë e pretenduar, apo në drejtim të thellimit të hetimit në lidhje me këtë element. Trupa gjyquese nuk rezulton gjithashtu ta ketë bërë prezente këtë çështje në takimet e saj para marrjes së vendimit nr. 3, datë.19.03.2018 dhe as të jetë shprehur apo të ketë mbajtur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë çështje në Aneksin nr. 2 që paraqet gjetjet për të cilat trupa i kalon subjektit barrën e provës.
19. Në analizë të komunikimeve të trupës gjyquese me subjektin e rivlerësimit, pas komunikimit të barrës së provës (rezultatet e hetimit paraprak), nuk rezulton gjithashtu që kjo çështje të jetë bërë pjesë e këtyre komunikimeve në asnjë formë. Subjekti ka kthyer përgjigje për çështjet e ngritura në Aneksin nr. 2 dhe ka komunikuar me plotësim përgjigjesh me trupën në vazhdim të këtyre çështjeve.
20. Për më tepër, nga leximi i kujdesshëm i procesverbaleve të mbledhjeve të trupës gjyquese, të datave 05.04.2018, 30.04.2018, 07.05.2018 (*diskutimet përfundimtare pas seancës*), nuk gjendet asnjë diskutim i vetëm mes anëtarëve të trupës apo vëzhguesit ndërkombëtar për detyrimin e pashlyer të subjektit në lidhje me provimin e burimit të ligjshëm të pasurisë së z. {***}. Në këtë kontekst, jo vetëm subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i njoftuar dhe ndërgjegjësuar për këtë gjetje, por as vetë trupa gjyquese nuk rezulton ta ketë bërë këtë gjetje një nga çështjet për diskutim dhe që çon në ngritjen e prezumimit ligjor për masë disiplinore. Këtë qëndrim të trupës gjyquese në lidhje me këtë detyrim e gjejmë vetëm në vendimin përfundimtar që vendos masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.
21. Komunikimi i bërë me personin tjetër të lidhur në lidhje me provueshmërinë e burimit të ligjshëm të pasurisë së tij, nuk legjitimon shmangien nga detyrimi i qartë ligjor për t’i kaluar barrën e provës për këtë fakt subjektit, i cili është e vetmja palë që në këtë proces ka të drejta e detyrime e që për mosrealizimin e tyre ligji e ngarkon atë dhe vetëm atë me përgjegjësinë e marrjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Personi tjetër i lidhur mund të jetë një individ i cili nuk ka asnjë vullnet të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij në një proces i cili për të, nga pikëpamja ligjore, nuk prodhon asnjë pasojë. Madje personi tjetër i lidhur mund të jetë në kohën e zhvillimit të procedurës administrative një person i cili nuk ka më një marrëdhënie të shëndetshme e miqësore me subjektin e rivlerësimit dhe, për pasojë, qëllimet e interesat e tij mund të jenë krejt të kundërta me ato të subjektit të rivlerësimit dhe kjo qasje mund të prodhojë një qëndrim krejt pasiv e dashakeqës ndaj këtij detyrimi për të

provuar ligjshmërinë e pasurisë së tij të dhënë hua apo të dhuruar subjektit të rivlerësimit. Për këto arsye, ligji ka parashikuar se në marrëdhënien me Komisionin, në funksion të provimit të këtij fakti, barrën e provës e ka subjekti i rivlerësimit, i cili është individ i qe nga ky proces mbart përgjegjësinë.

22. Përfundimisht, në analizë të rrethanave të mësipërme, kam arritur në konkluzionin se subjekti të rivlerësimit Fatmir Hoxha, në kundërshtim me nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk i ka kaluar barra e provës për të provuar ligjshmërinë e pasurisë së personit tjetër të lidhur me të, z. {***}, duke iu mohuar në këtë mënyrë mundësia për të paraqitur pretendime e prova e për t'u dëgjuar në lidhje me këtë çështje.
23. Në lidhje me çështjen e tretë (4.3) që lidhet me faktin nëse gjendej Kolegji në kushtet e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012 për sa i përket pretendimit të subjektit të paraqitur në ankim në lidhje me marrjen e provave të reja, analiza dhe trajtimi i çështjes do të shihen të lidhur me konkluzionin e arritur në çështjen e mësipërme. Konkluzioni për situatën faktike të përshkruar më lart, do të shihet në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.
24. Në ankimin e paraqitur, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar marrjen me cilësinë e provës së disa akteve shkresore, të cilat ia ka bashkangjitur ankimit. Aktet janë shkresa të nxjerra në përgjigje të kërkesës së shtetasit {***} drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave; Degës së Doganës Durrës e Shkodër; Ambasadës Italiane në Tiranë; Konsullatës Italiane në Shkodër; Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor Tiranë e Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Shkodër dhe kanë si qëllim dokumentimin e aktivitetit të tij tregtar, i cili konsiderohet si burimi i ligjshëm i pasurisë së krijuar prej tij, e cila i është dhënë hua subjektit të rivlerësimit. Kërkesat janë paraqitur pas marrjes së vendimit nga trupa gjyquese e Komisionit dhe në reagim të shkaqeve të përmendura në të.
25. Në analizë të të gjitha rrethanave të cituara më lart, të faktit dhe ligjit, çmoj se Kolegji gjendej para kushteve të parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012.
Së pari, rezulton që këto prova nuk janë paraqitur në procedurën administrative të zhvilluar nga trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në momentin procedural të paraqitjes së provave. Për pasojë, vendimmarrja e trupës gjyquese është bërë pa i konsideruar faktet që këto akte provojnë dhe pa ia nënshtruar ato vlerësimit tërësor të trupës.
Së dyti, subjekti provon se ato nuk i janë paraqitur trupës jo për faj të subjektit, duke qenë se në dijeninë e tij nuk ishte konkluzioni i trupës se nuk provohej burimi i ligjshëm i pasurisë së personit të lidhur. Në këto rrethana, subjekti nuk i janë kërkuar këto akte dhe as ka pasur mundësinë të vlerësojë se janë të nevojshme apo se mungesa e paraqitjes së tyre mund ta ngarkonte atë me ndonjë konsekuencë ligjore, si ajo e masës disiplinore.
26. Në këto kushte, kam vlerësuar se paraqitja bashkë me ankimin e provave të reja të përcaktuara si më lart, gjejnë mbështetje në parashikimin e përjashtimit që neni 47 i ligjit nr. 49/2012, i cili legjitimon paraqitjen e tyre në këtë fazë të procesit gjyqësor.
27. Në konkluzion kam gjykuar se Kolegji, në zbatim edhe të detyrimit kushtetues të parashikuar nga Neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: “Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit. Kolegji

vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit, dhe si i tillë bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj". Pra, Kolegji gjendej në situatën në të cilën duhet të lejonte marrjen e provave të reja të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit, për të ndrequr këtë gabim procedural të Komisionit gjatë fazës së procedurës administrative, si edhe për shkak se nuk konstatohet se gjendemi përpara ndonjërisë prej rrethanave të refuzimit të marrjes së provës të parashikuar nga neni 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

28. Në lidhje me çështjen e katërt (4.4) që shtrohej për zgjidhje e që i përket analizës së rrethanave që detyrojnë gjykimin në seancë gjyqësore publike, në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, mendoj se së pari duhet të citohet e duhet marrë në konsideratë përmbajtja e dispozitës që do përdoret për zgjidhjen e saj.

Neni i aplikueshëm për këtë moment procedural është neni 51 i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon: "Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se:

- a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji;
- b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;
- c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë."

29. Në zbatim të germës "a" të dispozitës së sipërcituar dhe duke përdorur konkluzionin e arritur në çështjen e mësipërme, çmoj se plotësohej kushti i kësaj germe për të vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me qëllim marrjen e provave të reja të paraqitura nga subjekti bashkë me ankimin. Marrja e këtyre provave do t'i shërbente së pari Kolegjit për të konstatuar saktësisht provueshmërinë ose jo të burimit të ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, z. {***}, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

30. Së dyti, konstatohet se nga shqyrtimi dhe analiza e akteve të administruara, në këndvështrim të pretendimit apo shpjegimit të subjektit në lidhje me diferencën prej 1.752.123 lekësh, të konstatuar në vitin 2011, ishte i nevojshëm dëgjimi dhe shpjegimi në seancë gjyqësore i drejtpërdrejtë i palës, në mënyrë që të konstatohet saktë e qartë kjo situatë faktike. Konstatohet që vendosja e shifrës prej 2.500.000 lekësh si shpenzim për mobilimin e banesës së subjektit, është mbështetur vetëm në deklarinë e tij dhe subjekti ka qenë i qartë në përcaktimin e kësaj shifre. Në ndryshim me këtë, subjekti ka qenë i paqartë në drejtim të përcaktimit të kohës në të cilën ai ka realizuar mobilimin e shtëpisë dhe ka shpenzuar shifrën e mësipërme, si edhe në drejtim të përballimit me burime të ligjshme të këtij zëri shpenzimesh. Ai deklaroi se një pjesë e këtij shpenzimi është përballuar nga të ardhurat e përfituara nga shitja e orendive shtëpiake të shtëpisë që kishte më parë në Shkodër. Në ankimin e tij, subjekti parashtron disa rrethana të ndryshme lidhur me këto elemente, të cilat sipas pretendimit ndikojnë në përcaktimin kohor të kryerjes së këtij shpenzimi.

Në vlerësimin tim, në analizë të kësaj situatë dhe duke mbajtur parasysh faktin se e vetmja provë e përdorur në vendimin e Komisionit për të deklaruar si të pajustificuar me burim të ligjshëm shumën e mësipërme, është pohimi dhe deklarinë e subjektit, të cilat rezultojnë të jenë jo të qarta e të plota përgjatë procedurës administrative, shkohet në konkluzionin se gjendemi para shkakut të parashikuar prej nenit 51, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 49/2012 që përcakton gjykimin e çështjes në seancë publike. Në këtë kontekst, kam vlerësuar se shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palës është i nevojshëm edhe për të

përcaktuar drejt këtë rrethanë nëpërmjet ripyetjes dhe kërkimit të shpjegimeve prej palës në seancë gjyqësore para gjithë trupës gjyqësore.

31. Për të gjitha sa më lart, kam qenë në favor të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, sepse do të ishin sqaruar këto dy shkaqe të shkarkimit të subjektit duke i garantuar subjektit të rivlerësimit një proces të drejtë dhe vetë trupës gjyqësore një bazë faktike më të qartë mbi të cilën do të vendoste në lidhje me çështjen.
32. Në kushtet kur Kolegji me shumicë votash vendosi të shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi pa konsideruar rrethanat që u përshkruan më lart, kam votuar kundër vendimmarrjes së trupës gjyqësore edhe për sa i përket themelit të çështjes, duke qenë e mendimit se vendimi nr. 18, datë 10.05.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të duhej të ndryshohej e subjekti i rivlerësimit të konfirmohej në detyrë.
33. Vlerësimi i çështjes në themel pashmangshmërisht është i lidhur me situatën faktike të paqartë, të përshkruar më lart, e cila në gjykimin tim në këtë rast do të duhet të vlerësohet në favor të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që kjo paqartësi vjen si rrjedhojë e një procesi jo të drejtë që i ka kufizuar subjektit të rivlerësimit mundësinë e garancitë për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur lidhur me faktet që në këtë rast çojnë drejt prezumimit të masës së shkarkimit nga detyra dhe gjithashtu për mungesë të qartësisë së situatës faktike, e cila pengon krijimin e një bindjeje të brendshme që mbështet vendimin e Komisionit.

Në analizë të shkaqeve që Komisioni ka përdorur për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, gjykoj se ato nuk janë të tilla që të justifikojnë vendosjen e masës disiplinore ndaj subjektit duke arsyetuar si më poshtë.

34. Komisioni ka konsideruar si shkak të parë për shkarkimin e subjektit, faktin se ai kryer *deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën “vetting” nuk është deklaruar si burim huaja e marrë shtetasit {***}, në vlerën prej 28.500 eurosh.*
Mungesa e deklaramit të këtij burimi për krijimin e pasurisë apartament, në deklaratën “vetting”, vjen në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 e shtojcën nr. 2 “Formulari i deklaramit të pasurisë”, duke bërë në këtë mënyrë deklarim të pamjaftueshëm sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
35. Nga shqyrtimi i deklaratës së pasurisë *vetting* 2017, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë së tij të vetme, përkatësisht apartament 2 + 1 me sipërfaqe totale 112,36 m², rruga “{***}”, Tiranë:
 - *pagën e subjektit dhe të bashkëshortes;*
 - *interesat e përfituara nga depozita bankare e bashkëshortes;*
 - *të ardhurat nga shitja e banesës në Shkodër;*
 - *kreditin lehtësuese në BKT, me nr. 424 rep., nr. 204 kol., datë 27.02.2012, sipas ligjit 9232 dhe VKM-së 66, datë 12.09.2007 (5 milionë lekë me interes kreditimi 4%, me afat shlyerje 22 vjet).*

Në këtë deklaratë, siç konstaton edhe Komisioni, subjekti nuk ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie huan e marrë nga kunati i tij, z. {***}, në shumën prej 28.500 eurosh, duke deklaruar se kjo hua ishte e shlyer në kohën e përpilimit të kësaj deklarate.

Ndërkohë që, nga shqyrtimi i deklaratës periodike të viti 2012, në të cilën janë deklaruar pasuritë dhe interesat e vitit 2011, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit ka blerë pasurinë apartament, është deklaruar si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie huaja e mësipërme, koha e marrjes, shuma dhe shlyerja e një kësti prej 3.900 eurosh në fund të vitit kalendarik.

Në deklaratat periodike vijuese të vitit 2012, 2013, 2014, subjekti gjithashtu deklaroi se ka shlyer respektivisht shumat prej 6700 eurosh, 8000 eurosh dhe 9900 eurosh, duke shlyer plotësisht në vitin 2014 të gjithë shumën e marrë hua prej kumatit të tij.

36. Rezulton se shlyerja e kësaj huaje është bërë prej të ardhurave nga paga e subjektit dhe bashkëshortes së tij pasi ata nuk konstatohet të kenë burime të tjera të ardhurash.

Në këtë kontekst, huaja si burim i krijimit të kësaj pasurie në kohën e krijimit të pasurisë është shlyer me të ardhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes së tij, prandaj, për sa kohë që është likuiduar plotësisht nëpërmjet shlyerjes nga ky burim, në momentin e përpilimit të deklaratës *vetting* 2017 ajo nuk ekzistonte. Përpos këtij fakti (që kjo hua nuk ekziston si e tillë në kohën e përpilimit të deklaratës *vetting* 2017), ajo dhe nuk gjen pasqyrim për pasojë as në faqen e formularit në të cilin deklarohen detyrimet e subjektit dhe të personave të lidhur të mbetura ende pa u shlyer ndaj personave fizikë dhe juridikë në momentin e përpilimit të deklaratës *vetting* 2017.

E gjithë kjo panoramë e situatës faktike tregon qasjen psikike të subjektit ndaj kësaj të dhëne, e cila nuk është parë e konsideruar prej tij si e deklarueshme në momentin e hartimit të deklaratës, por që është konsideruar si e tillë në momentin e lindjes së detyrimit dhe përdorimit si burim për financimin për blerjen e apartamentit, si edhe për gjatë gjithë kohës që ajo ka ekzistuar si një detyrim për t'u shlyer nga subjekti.

37. Dispozitat ligjore që rregullojnë detyrimin për të deklaruar burimin e krijimit të pasurive, me përjashtim të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPI-së nuk specifikojnë qartazi se duhet deklaruar burimi në momentin e krijimit të pasurisë, duke e lënë disi evaziv specifikimin e kësaj të dhëne.

Pavarësisht, edhe në versionin që pranojnë se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të deklarojë në deklaratën *vetting* 2017 burimin e krijimit të pasurisë në momentin e krijimit dhe ai nuk e bën këtë, duke plotësuar jo saktë në këtë mënyrë deklaratën *vetting*, vlerësoj se Komisioni, por edhe Kolegji, duhet të analizonte të gjitha rrethanat e çështjes për ta konsideruar nëse kjo pasaktësi është bërë në funksion të përpjekjes për të fshehur apo deklaruar jo saktë pasuritë, siç përcakton neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

38. Subjekti prezumohet se është në dijeni të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se deklaratimet periodike të pasurisë në vite mund të merren si provë nga Komisioni dhe nuk do gjendej asnjë vijë logjike e qëndrueshme nëse do të pranohet se ai me mosdeklarimin në deklaratën *vetting* 2017, të kësaj huaje ka pasur për qëllim të fshehtë këtë hua si një nga burimet e krijimit të pasurisë së tij, për sa kohë që e ka deklaruar atë dhe statusin e saj rregullisht përgjatë katër viteve të deklaratimeve periodike. Në bindjen time, mosdeklarimi i kësaj të dhëne si një burim për krijimin e pasurisë, ka ndodhur për shkak të kuptimit të ligjit në drejtimin e përshkruar më lart si për shkak të këndvështrimit personal të subjektit, ashtu edhe për shkak të mungesës së qartësisë në dispozitat ligjore të kësaj kërkesë.

39. Në konkluzion, mendoj se Komisioni dhe Kolegji kanë gabuar kur e kanë vlerësuar këtë rrethanë si një rrethanë që mund të konsiderohet se plotëson kushtin e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si edhe e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

40. Shkaku tjetër i përdorur nga Komisioni dhe Kolegji si një nga shkaqet e shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, i lidhur gjithashtu me huan e marrë për blerjen e apartamentit, është fakti se subjekti nuk arriti të provonte burimin e ligjshëm të pasurisë së kumatit të tij, z. {***}, për shumën prej 28.500 eurosh.

41. Për analizën e këtij shkak, do të doja të risillja në vëmendje arsyetimin e mësipërm se subjektit të rivlerësimit nuk iu dha mundësia të provonte plotësisht këtë rrethanë, duke iu mohuar e drejta

e paraqitjes e marrjes për shqyrtim të provave që ai pretendonte se provonin këtë detyrim ligjor. Pavarësisht kësaj rrethane por, pa e abstraguar atë plotësisht, vlerësoj se edhe në analizë të fakteve që rezultojnë nga provat e administruara nga Komisioni, Kolegji do të duhej të arrinte në një konkluzion të ndryshëm.

42. Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë procedurës administrative, rezulton se kunati i subjektit të rivlerësimit, z. {***}, ka hyrë në një marrëdhënie huaje me subjektin për shumën prej 28500 eurosh në muajin shkurt 2011, kjo sipas deklarimeve të vetë subjektit. Këtë marrëdhënie e ka konfirmuar edhe personi tjetër i lidhur gjatë deklarimeve të tij, të dhëna në Komision, në datën 21.02.2018.

Komisioni ka administruar në cilësinë e provës disa *statement-e* bankare të nxjerra nga banka *Pro Credit*, që tregojnë ekzistencën e disa depozitave bankare në emër të personit tjetër të lidhur, të cilat sipas analizës financiare të bërë edhe në Kolegj, kapin shumën totale prej 25000 eurosh, në kohën e dhënies së huas. Këto depozita e llogari rrjedhëse janë hapur në bankën *Pro Credit*, duke filluar që nga viti 2004, 2005, 2006, 2009 e 2010 nga personi tjetër i lidhur, me shuma respektivisht mesatare, që së bashku me interesat e përfituara kapin shifrën (gjendje) prej 25.000 eurosh në datën 03.02.2011.

43. Kjo situatë faktike tregon dhe provon faktin se personi tjetër i lidhur ka zotëruar shumën e dhënë hua, përveç shumës prej rreth 4 mijë eurosh që deklaroi se e ka pasur në banesë, realisht brenda sistemit bankar dhe shumë kohë më parë se subjekti i rivlerësimit dhe ai të futeshin në marrëdhënien e huas. Kjo gjendje likuiditeti ka ekzistuar në favor të personit të lidhur, e shpërndarë nëpër depozita të ndryshme të krijuara me shuma nga 2500 – 5000 euro, të shpërndara në vite, gjë që tregon se depozitimi i tyre është bërë në mënyrë krejt të pavarur e autonome nga zotëruesi i tyre, për nevojat e tij dhe në përputhje me qëllimin, vizionin apo interesin e tij për administrimin e tyre. Për më tepër, personi tjetër i lidhur ka qenë krejt i hapur me institucionet financiare në vend duke i depozituar ato në sistemin bankar, fakt që presupozon mospasjen e ndonjë shqetësimi që lidhet me ligjshmërinë e burimit të tyre.
44. Situata e mësipërme të bën të mendosh se këto para janë fituar në vite nga burime që mund të deklaroheshin e mund të kontrolloheshin dhe pa pasur apo shfaqur ndonjë shqetësim në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së burimit të tyre. Sigurisht që ky proces akumulimi i të ardhurave në vite është bërë nga personi tjetër i lidhur, pa imagjinuar e parashikuar miratimin e reformës në drejtësi e detyrimin e tij të ardhshëm për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre.
45. Përpos kësaj analize, personi tjetër i lidhur në deklaratimet që ka bërë para Komisionit, ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie ka qenë aktiviteti i tij tregtar si person fizik, që ka tregtuar automjete e veshje të përdorura përgjatë viteve, duke filluar që në vitin 1995 e në vijim. Ai ka deklaruar se ka shitur automjete dhe është taksuar me një taksë peshe për tregtimin e veshjeve të përdorura, aktivitet të cilin e ka realizuar fillimisht me një furgon e më pas me një kamion në pronësi të tij. Ka deklaruar gjithashtu se nuk disponon dokumente për shkak të kohës së gjatë, duke nënvizuar faktin se Komisioni mund t'i drejtohej Doganës për t'i marrë ato. Në mënyrë të përsëritur ka theksuar idenë se paratë i ka pasur në bankë prej kursimeve të tij, çdo herë që është pyetur për burimin e ligjshëm të tyre.
46. Ajo që vihet re nga deklarimi i tij, është fakti se ai është konsekuent në drejtim të identifikimit të aktivitetit që ai ka kryer, i cili është edhe burimi i të ardhurave të krijuara: tregtia e automjeteve e veshjeve të përdorura. Në këndvështrim të kuadrit ligjor në fuqi, në kohën e kryerjes së këtij aktiviteti, rezulton se një aktivitet tregtar i tillë nuk ishte i ndaluar të kryhej nga individ. Duhet pasur në konsideratë në këtë rast parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili në pikën 1, gerrat “b” e “i” të tij

parashikon: “Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon: b) të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë; i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.”

47. Kufizime në drejtim të kryerjes së tregtimit të automjeteve nga individë të palicencuar gjejmë vetëm në vitin 2015, në VKM-në nr. 806, datë 30.09.2015, “Për miratimin e planit të masave në kuadër të informalitetit në transportin rrugor”, i cili miratonin një plan masash në funksion të qëllimit të shpallur në titullin e këtij akti dhe në pikën 5 të tij parashikon nevojën për ndërhyrje në ligjin për QKR-në, në drejtim të kufizimit të numrit të automjeteve deri në dy të tillë, që mund të importojë një individ në një vit. Miratimi i këtij akti nënligjor, me këtë përmbajtje, tregon se deri në atë moment tregtimi i automjeteve nga individë të palicencuar ishte një realitet i cili nuk ishte i ndaluar dhe madje as i rregulluar në mënyrë të posaçme me ndonjë akt të veçantë.
48. Në analizë të këtyre rrethanave, çmuj se aktiviteti i deklaruar si burim i krijimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. {***}, duhet konsideruar si një aktivitet që mund të konsiderohet si një burim i ligjshëm i pasurisë së dhënë hua prej tij subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
49. Për të arritur në një konkluzion më të saktë rreth këtij shkak, siç kam arsyetuar më lart, Kolegji do duhej të analizonte provat e reja që subjekti kishte paraqitur e që në thelb i referoheshin një korrespondence me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Ministrinë e Brendshme për Sistemin TIMS, Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor e kontratave për shitblerje automjete, që në një analizë formale të ekstremiteteve, pa i hyrë brendisë së tyre, tregojnë pikërisht dokumentacionin e munguar në hetim, për të cilin personi tjetër i lidhur i ka kërkuar ndihmë Komisionit ta marrë, dhe që duket se provon apo dokumenton pikërisht aktivitetin që pretendohet se është kryer nga personi tjetër i lidhur.
50. Në këtë kuptim, edhe në drejtim të këtij shkak, çmuj se konkluzioni i KPK-së është i padrejtë dhe i pambështetur në një hetim të plotë e të gjithanshëm, për më tepër që edhe mbështetur në të dhënat që janë administruar duket se provohet që personi tjetër i lidhur jo vetëm që i ka zotëruar likuiditetet që ka dhënë hua, por edhe i ka fituar ato nëpërmjet një burimi të ligjshëm.
51. Shkak tjetër i shkarkimit të subjektit të rivlerësimit lidhet me konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk ka justifikuar burimin e ligjshëm për shumën prej 1.752.123 lekësh, shpenzuar në vitin 2011.
Konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë shkak arrihet në përfundim të analizës financiare të bërë për vitin 2011, vit në të cilin subjekti ka blerë apartamentin në pronësi të tij, dhe sipas vlerësimit të Komisionit ka shpenzuar shifrën prej 2.500.000 lekësh për mobilimin e tij. Komisioni e ka mbështetur vendosjen e kësaj shume si shpenzim të kryer në vitin 2011, mbështetur në përgjigjet që ka dhënë subjekti i rivlerësimit ndaj pyetjes se sa keni shpenzuar për mobilimin e banesës, drejtuar nga Komisioni gjatë procesit të hetimit administrativ.
Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti ka deklaruar: “[...] pas blerjes së banesës në vitin 2011, kam bërë shpenzime për arredimin e saj në shumën rreth 2.500.000 lekë [...].”
52. Në vijim të hetimit administrativ dhe pas kalimit të barrës së provës për këtë fakt, dhe konkluzionit se kjo gjetje e ngarkonte subjektin me një shumë të pajustificuar prej 1.752.123 lekësh për vitin 2011, subjekti është përpjekur të shpjegojë disa rrethana të tjera të cilat në këndvështrimin e tij dukej se i jepnin përgjigje këtij pretendimi.
53. *Së pari*, ai ka thënë që pjesë e kësaj shume është edhe shuma e përfituar prej shitjes së orendive të shtëpisë së vjetër në Shkodër, pa përcaktuar shumën, por duke specifikuar orenditë e shitura,

disa herë edhe personat që ua ka shitur, edhe duke dhënë numrat e telefonit për disa prej tyre me qëllim mundësinë e identifikimit të tyre e bërjen sa më të besueshme të shitjeve. Të ardhurat e përfituara nga shitja e këtyre orendive janë transformuar në orendi të reja për apartamentin e ri, pa krijuar të vlera të shtuara në të ardhurat e subjektit në fund të vitit kalendarik për të cilin kryhet deklarimi periodik, për pasojë gjendet i pavend konkluzioni i shumicës se ai i ka fshehur këto të ardhura në deklaratimet periodike.

Së dyti, ka pretenduar jo në mënyrë të qartë faktin se mobilimi i shtëpisë, ashtu si edhe shitja e orendive të shtëpisë së vjetër nuk ishte kryer vetëm gjatë viti 2011, por edhe gjatë viti 2012, sipas pretendimeve të paraqitura gjatë hetimit, edhe më gjatë e shtrirë në kohë sipas pretendimeve të paraqitura në ankim.

54. Ajo që do doja të nënvizoja që në fillim, është arsyetimi i përdorur në qëndrimin tim për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, me qëllim sqarimin e kësaj situate faktike e cila nuk rezultoi nga hetimi që ka zhvilluar Komisioni dhe do nevojitej të sqarohet nëpërmjet një procesi ripyetjeje të subjektit në seancë gjyqësore.
55. Në kushtet e mospasjes së mundësisë për të verifikuar saktësisht këtë situatë faktike që do të çonte Kolegjin në një konkluzion të drejtë dhe më afër të vërtetës në lidhje me këtë fakt, mendoj që përsëri edhe në analizë të rrethanave që rezultojnë të hetuara prej Komisionit, Kolegji duhet të kishte mbajtur qëndrimin se ky konkluzion është nxjerrë në mënyrë të gabuar e duke mos bërë një analizë të plotë e të gjithanshme të rrethanave të faktit.

Së pari, duhet të nënvizoj faktin se konkluzionin e tij se kjo shumë është shpenzuar për mobilimin e banesës, Komisioni e ka mbështetur vetëm në deklaratimin e subjektit si burim prove. Nuk rezultoi asnjë provë tjetër e administruar nga hetimi administrativ, e çfarëdo lloji, e cila të japë të dhëna të njëjta apo të ngjashme me këtë fakt apo ta mbështesë atë qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, duke përbërë qoftë një indicie të vlefshme që të mbështeste konkluzionin e Komisionit.

Së dyti, Komisioni paradoksalisht ka vlerësuar si të vërtetë vetëm pjesën e deklaratimit të subjektit që lidhet me shumën e shpenzuar për mobilimin, por nuk ka vlerësuar në raport me të dhënat e tjera mungesën e përcaktimit të kohës së kryerjes së këtij shpenzimi qartësisht, apo përpjekjet e subjektit për të përshkruar një kohë të kryerjes së këtij shpenzimi, të paktën jo në vitin 2011.

Së treti, Komisioni nuk ka bërë një vlerësim të njëjtë as për deklaratimin e subjektit në lidhje me shitjen e orendive të shtëpisë së vjetër, duke e mohuar krejtësisht vlerën që ky transaksion ka pasur, pavarësisht përpjekjeve të subjektit, përtej një kujdesi mesatar për të identifikuar çdo send apo blerës për këto orendi.

Së katërti, Komisioni, në kundërshtim me ligjin “Për tatimin për të ardhurat”, nuk ka njohur asnjë vlerë për shitjen e këtyre orendive me arsyetimin që për këto shitje nuk është paguar tatim fitimi nga subjekti dhe, për pasojë, këto të ardhura nuk janë të ligjshme në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Zbatimi i ligjit të mësipërm është i lidhur, për shkak të parashikimeve të tij, me tatimin e të ardhurave personale që pasqyrojnë fitim e vlerë të shtuar në pasurinë e një individi, ndërkohë që shitja e orendive të përdorura nuk mundet në asnjë mënyrë të prodhojë një shifër më të lartë se ajo e shpenzuar për blerjen e tyre, përveç rasteve të shitjes së orendive me vlera të veçanta historike e kulturore (rast i cili nuk rezultoi të jetë ky i shqyrtuar në gjykim), për pasojë të rezultojë në përfitimin e një fitimi nga diferenca e çmimit të blerjes me atë të shitjes nga subjekti.

Së pesti, konkluzioni se shpenzimi prej 2.500.000 lekësh është bërë i gjithi në vitin 2011, bie në kundërshtim edhe me të vetmet prova që Komisioni duhet të kishte konsideruar në këtë drejtim,

deklarimin periodik të viti 2011, në të cilin nuk ka asnjë deklaram të subjektit për kryerjen e këtij shpenzimi në këtë vit, ndërkohë që sipas analizës financiare edhe të vetë Komisionit, subjekti kishte mundësi të përballonte shpenzime për mobilim në këtë vit në vlerën rreth 747.000 lekë (shifër që del nga fakti i pranuar në vendim se janë shpenzuar 2.500.000 lekë dhe nuk mbulohej 1.752.000 lekë, pra diferenca prej rreth 747.000 lekësh mbulohej nga të ardhurat e subjektit).

56. Ky element që del nga analiza që bën vetë Komisioni, duke e parë të lidhur me: a) një analizë minimaliste financiare që realizoi Kolegji nëpërmjet këshilltarit ekonomik të Njësisë së Shërbimit Ligjor e që përcakton, referuar një statistike të INSTAT, se njësia ekonomike familjare shpenzon minimalisht 6% të buxhetit vjetor për mobilim shtëpie, një shifër minimale e mundshme për t'u përfituar nga shitja e orendive të tjera prej rreth 380.000 lekësh; b) faktin e deklaruar prej subjektit se orenditë janë shitur mes viteve 2010 e 2012, që do të thotë minimalisht është përfituar shifra prej 190.000 lekësh në vitin 2011 e 190.000 lekësh në vitin 2012, do të dilnim në një konkluzion logjik se subjekti duhet të ketë pasur minimalisht në dispozicion për mobilimin e shtëpisë në vitin 2011, shifrën prej rreth 937.877 lekësh (747.000 + 190.000). Nga faturimi i bërë prej OSHEE-së, por edhe nga deklaramet e vetë subjektit, të cilat përputhen në këtë drejtim, rezulton se subjekti ka filluar të banojë realisht në banesë në muajin shkurt 2012, kur edhe konsumi për energjinë elektrike demonstroi faktin se në atë banesë atë muaj është banuar efektivisht.
57. Në vijim të këtij arsyetimi, mbështetur në të dhënat që janë administruar në një analizë financiare të vitit 2011 të bërë mbi këto të dhëna e mbi shifrat e përdora nga INSTAT, arrihet në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit para se të fillonte të banonte në banesë, kishte potencialisht mundësinë të shpenzonte për mobilimin e saj shumë prej 937.877 lekësh. Në gjykimin tim, vlerësoj se kjo shifër është e mjaftueshme për të bërë të banueshëm në një nivel bazik një apartament me sipërfaqe 112 m², mobilimi i plotë i të cilit mund të ketë vazhduar më pas në kohë, siç ndodh përgjithësisht me të gjitha familjet mesatare shqiptare që fillojnë të banojnë në një apartament të ri.
58. Në konkluzion, mendoj se në kushtet e paqartësisë së kësaj situatë faktike, Kolegji duhet të kishte shqyrtuar këtë çështje në zbatim të parimit të objektivitetit e proporcionalitetit sipas parashikimit të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe të mos e konsideronte këtë situatë as si një fakt të provuar, siç e ka pranuar Komisioni dhe as si një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
59. Në lidhje me shkakun e katër të shkarkimit (paragrafi 3.5 më sipër), që i referohet mosdeklarimit të një depozite në favor të bashkëshortes së subjektit në deklaramin fillestar të vitit 2003, në shumë prej 330.000 lekësh, e cila është deklaruar në deklaramin periodik të vitit 2004 dhe është konsideruar si fshehje e pasurisë dhe, për pasojë, shkak për deklaram të pamjaftueshëm sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, gjykoj se është qëndrim i gabuar e në shkelje të ligjit.
60. *Së pari*, duhet të sjell në vëmendje faktin se objekt kontrolli sipas Aneksit të Kushtetutës e ligjit nr. 84/2016 janë pasuritë e interesat private të subjekteve të rivlerësimit, të cilat janë deklaruar në një deklaram të re të pasurisë, e cila i nënshtrohet verifikimit të vërtetësisë së saktësisë së deklarameve. Neni D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: "Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaram të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaramin e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, sipas ligjit." Në deklaramin e pasurisë *vetting* nuk rezulton që subjekti të

ketë një mungesë pasqyrimi të kësaj depozite, prandaj mendoj që Kolegji duhej të kishte vlerësuar se shkak i përmendur në këtë rast nuk është ai i parashikuar nga ligji.

61. *Së dyti*, neni D, në pikën 5 të tij parashikon gjithashtu se shkak për prezumimin e vendosjes së masës disiplinore, është çdo pasaktësi apo paplotësi që është bërë në përpjekje për të fshehur pasurinë e subjektit të rivlerësimit, dhe ky element i anës objektive duhet parë gjithmonë i lidhur me parashikimin e pikës 2 të nenit D, që të referon te deklaratat e pasurisë, e përpiluar sipas parashikimeve kushtetuese e atyre të ligjit nr. 84/2016. Në rastin konkret, nuk rezulton që kemi një pasaktësi apo mosdeklarim në deklaratën *vetting* 2017, por as një përpjekje për ta fshehur këtë pasuri as në deklaratimet periodike. Fakti që mosdeklarimi i vitit 2003 - për më tepër që është deklarimi fillestar që ka bërë subjekti - është korrigjuar duke u deklaruar saktësisht kjo depozitë në deklaratën e vitit 2004, tregon edhe për mungesën e qëllimit nga ana e subjektit për të fshehur këtë pasuri.
62. Përpos këtyre argumenteve, Komisioni ka pranuar gjatë hetimit administrativ se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie në vitin 2003 dhe e ka zhveshur atë nga barra e provës në drejtim të këtij fakti. Me vendimin nr. 4 datë 05.04.2018 të trupës gjyquese në pikën 2 të tij, është vendosur që të pranohet shpjegimi i subjektit për ligjshmërinë e justifikimin e krijimit të kësaj shume në vitin 2003 duke u refuzuar kërkesa e subjektit për marrjen e një prove që do të provonte ligjshmërinë e këtij burimi. Pra, gjendemi në situatën kur edhe në zbatim të situatës ligjore edhe të asaj faktike, subjekti nuk mund të konsiderohet se ka kryer në këtë rast një veprim që mund ta çojë drejt vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
63. Në përfundim, as ky shkak nuk mund të jetë një shkak ligjor për konkluzionet e vendimmarrjes së Komisionit.
64. Në përfundim të gjithë arsyetimit të mësipërm, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupës gjyquese për të lënë në fuqi vendimin nr. 18, datë 10.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke shprehur mendimin tim se ky vendim duhet të ndryshohet, në zbatim të nenit 66, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, dhe subjekti i rivlerësimit Fatmir Hoxha të konfirmohet në detyrë.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi